


Gjykata Speciale e Kosovës dhe Drejtësia Tranzicionale:

Përceptimet mbi GJSK-në në Kosovë dhe nevoja për një qasje gjithëpërfshirëse të DT-së



integra **PAX**
www.paxforpeace.nl

Kolofon

Publikim i PAX dhe INTEGRA

Autore: Kathelijne Schenkel

Marsh 2021

Fotoja në kopertinë: 'Dritat në korridor' nga E. Pançi në Unsplash.com

Faqosja: Het IJzeren Gordijn

Përkthyer në shqip nga: Visar Krusha

Falënderime

Autorja e falënderon Kushtrim Koliqin për aranzhimin e studimit të përceptimit me UBO Consultancy dhe për dhënien e komenteve dhe reflektiveve të dobishme për raportin. Kontributi dhe komentet përcjellëse të Dr. Gëzim Visokës kanë qenë gjithashtu shumë të dobishme dhe shumë të çmuara. Faleminderit edhe Dion van den Berg për rishikimin që i ka bërë tekstit dhe znj. Rosi-Selam Reusing, praktikante në PAX, për analizën e parë të artikujve akademikë dhe të mediave. Falënderime të singerta shkojnë edhe për të gjithë individët që morën pjesë dhe i dhanë njohuritë e tyre në studimin e përceptimit.

PAX

PAX punon me qytetarë dhe partnerë të përkushtuar për t'i mbrojtur civilët kundër akteve të luftës, për t'i dhënë fund dhunës së armatosur dhe për ta ndërtuar paqen e drejtë. PAX vepron në mënyrë të pavarrur nga interesat politike.

Kutia postare 19318
3501 DH Utrecht, Holandë
info@paxforpeace.nl
www.paxforpeace.nl

INTEGRA

Misioni i Integra është të ndihmojë zhvillimin e Kosovës, veçanërisht në kontekstin e të drejtave të njeriut dhe integrimit duke i trajtuar dhe promovuar rrëfimet dhe përvojat e komuniteteve të marginalizuara, duke kontribuar kështu në proceset e demokracisë, ndërtimin e besimit dhe bashkëjetesës.

<https://ngo-integra.org/index.html>

Përkthimet e këtij publikimi (në shqip dhe serbisht) janë aranzhuar nga INTEGRA, përmes një granti të Rockefeller Brothers Fund.



Gjykata Speciale e Kosovës dhe Drejtësia Tranzicionale:

Përceptimet mbi GJSK-në në Kosovë dhe nevoja
për një qasje gjithëpërfshirëse të DT-së

Shkurtësat

AAK	Alenca për Ardhmërinë e Kosovës
RRIGJ	Rrjeti i Informatave Gjyqësore
BmK	Ballafaqimi me të Kaluarën
BE	Bashkimi Evropian
EULEX	Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë
TPNJ	Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavi
UÇK	Ushtria Çlirimtare e Kosovës
GJSK	Gjykata Speciale e Kosovës (DHS dhe ZPS)
KFOR	Forca e Kosovës; Forcat paqeruajtëse në Kosovës të udhëhequra nga NATO
LDK	Lidhja Demokratike e Kosovës
NATO	Aleanca Veri-Atlantike
PDK	Partia Demokratike e Kosovës
DHS	Dhomat e Specializuara
ZPS	Zyra e Prokurorit Special
PSRK	Prokurori Special i Republikës së Kosovës
TFSH	Task Forca Speciale Hetuese
DT	Drejtësia Tranzicionale
SHBA	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
UNMIK	Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë

Përbajtja

Shkurtesat	4
Përbledhje ekzekutive	6
1. Parathënie	8
2. Origjina, sfidat dhe zhvillimet rrreth Gjykatës Speciale të Kosovës	11
2.1 Lufta në Kosovë dhe ndjekja penale e kimeve të luftës	11
2.2 Komunikimi i GJSK-së me publikun	19
2.3 Faza e re: aktakuzat publike të GJSK-së	20
2.4 Kritikat ndaj GJSK-së	24
3. Të gjeturat e Studimit të Përceptimit të Publikut mbi Gjykatën Speciale të Kosovës 2020	28
3.1 Njohuritë e publikut mbi GJSK-në mbeten në nivel të ulët	29
3.2 Publiku e mbështetë ndjekjen penale të kimeve por GJSK-ja është e padrejtë	32
3.3 Besimi se GJSK-ja do të sjellë drejtësi mbetet i ulët	35
4. Përfundimet dhe rekondimet	41
SHTOJCA 1: Studimi i Përceptimit të Publikut 2020	44
SHTOJCA 2: Tabelat me të dhëna të Studimit të Përceptimit të Publikut	48

Përbledhje ekzekutive

Dhomat e Specializuara të Kosovës dhe Zyra e Prokurorit Special ('Gjykata Speciale e Kosovës'), e kriuar në vitin 2015, është mekanizmi më i fundit për t'i gjykuar krimet e luftës dhe krimet kundër njerëzimit në lidhje me Luftën në Kosovë të viteve 1998-1999. Shumica e përpjekjeve për tu ballafaquar me të kaluarën e luftës në Kosovë janë përqendruar në ndjekjen penale të krimeve të luftës, pa investuar shumë në mekanizmat e tjerë të drejtësisë tranzicionale për ta mbështetur shoqërinë për të shkuar drejt një të ardhmeje më paqësore. Gjykatat e mëparshme ndërkombëtare, dhe gjykatat e brendshme në Kosovë dhe Serbi, kanë arritur ta ndjekin penalisht një numër relativisht të vogël të krimeve të rënda. Si rezultat, ato nuk i përbushën pritet e shumë viktimate dhe nuk bënë shumë për ta rivendosur besimin e qytetarëve në proceset e drejtësisë. Për më keq, si në Kosovë ashtu edhe në Serbi të dyshuarit e pafajshëm ose autorët e dënuar konsiderohen si heronj dhe shumë prej tyre arritën të qëndrojnë ose të kthehen në pozitat e pushtetit politik. Nga të dyja palët, diskursi politik nationalist është brumosur në një masë të madhe nga kjo e kaluar e luftës, e cila i përcakton narrativat përjashtuese të viktimate dhe autorëve të krimeve.

Gjykata Speciale e Kosovës u kriua si përgjigje ndaj pretendimeve serioze se udhëheqja e ish Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), shumica e të cilëve u bënë politikanë pas luftës, ishin përfshirë në krime të rënda kundër serbëve, minoriteteve tjera dhe kundërshtarëve shqiptarë. GJSK-ja funksionon brenda sistemit gjyqësor të Kosovës por e inkorporon ligjin ndërkombëtar humanitar dhe funksionon si plotësish e pavarur. Vendimi për krijimin e këtij entiteti gjyqësor hibrid të veçantë ka qenë subjekt i shumë kritikave dhe kjo nuk ishte vetëm një shqyrtim ligjor ose i të drejtave të njeriut por edhe politik: me Kosovën në listën e anëtarësimit të BE-së, BE-ja u desh ta mbështeste hetimin e këtyre akuzave serioze, pasi mekanizmat e mëparshëm të mbështetur nga sundimi i ligjit në Kosovë e kishin shmangur ndjekjen e peshkut të madh. Krimet e pretenduara meritojnë të hetohen penalisht dhe të ndiqen penalisht në mënyrë që drejtësia të vendoset për viktimat. Sidoqoftë, projekt i GJSK-së dështoi në një aspekt të rëndësishëm: ajo i shqyrton vetëm krimet e pretenduara të kryera nga njëra palë në konflikt. Mandati i saj i kufizuar për t'i ndjekur penalisht vetëm krimet në lidhje me UÇK-në, është çështja kryesore në pranimin e GJSK-së nga një pjesë e gjerë e shoqërisë së Kosovës.

Pas disa viteve relativisht të qeta që nga viti 2015, një fazë e re për GJSK-në filloi në vitin 2020 kur u njofua për ngritjen e aktakuzave të para. Për ta testuar opinionin publik të Kosovës mbi GJSK-në, PAX dhe Integra e filluan një studim të përceptimit publik në shtator të vitit 2020 dhe i krahasuan të gjeturat e tij me studimin e përceptimit të vitit 2017, i cili kishte hasur në pak kuptim të publikut për GJSK-në. Të dhënët e vitit 2020 tregojnë se në Kosovë ende ka kuptim të kufizuar për mandatin e GJSK-së. Në mesin e shqiptarëve të Kosovës, ka rënë besimi se GJSK-ja do të vendosë drejtësi, ndërsa te serbët e Kosovës ai është rritur pak. Kjo mund të ketë të bëjë me ndikimin e diskursit etno-nacionalist rreth thirrjes së GJSK-së në vitin 2019 dhe 2020, me shumicën e shqiptarëve të Kosovës që mendojnë se mandati i GJSK-së është i padrejtë, përderisa shumë serbë

të Kosovës dhe të tjerë të Kosovës, e konsiderojnë atë të drejtë. Dallimet në besimin e shprehur, tregojnë për gjasat që grupe të ndryshme etnike t'i shohin ndryshe rezultatet e gjykimeve të GJSK-së.

Argumenti kryesor i këtij raporti është se përqendrimi dominues në gjykimet e krimeve të luftës që e trajtojnë të kaluarën e dhunshme në Kosovë, ka bërë pak për ballafaqimin me të kaluarën në një nivel shoqëror për të përparuar si një shoqëri paqësore, gjithëpërfshirëse dhe që shikon përpara. Ka pasur mungesë të investimit në aspekte tjera të rëndësishme, si: kërkimi i së vërtetës dhe dokumentimi, përkujtimi, dëmshpërbllimet dhe kompensimi, si dhe njohja dhe mbështetja për të gjitha viktimat dhe të mbijetuarit e konfliktit, pavarësisht identitetit dhe statusit të tyre. Të gjitha këto dimensione të drejtësia tranzicionale duhet të adresohen në vetvete për ta ndihmuar shoqërinë kosovare të shkojë drejt një të ardhmeje më paqësore. Me mandatin e saj të pjesshëm, GJSK-ja nuk do të kontribuojë shumë për këtë qëllim, përvèç për heqjen e mundshme nga sistemi të disa liderëve politik. A do të mundet GJSK-ja të kontribuojë pozitivisht në një kuptim më të gjerë, krahas vendosjes deri në një masë të drejtësia për viktimat, do të varet nga mënyra se si ajo është në gjendje ta shpjegojë mandatin e saj dhe procedurat gjyqësore në një kontekst të politikës së polarizuar rreth saj. Në dritën e procedurave aktuale të GJSK-së, është koha që qeveria e Kosovës dhe mbështetësit e saj ndërkombëtarë të investojnë në një qasje gjithëpërfshirëse për t'u ballafaquar me të kaluarën. Kapitulli i fundit i këtij raporti ofron rekondime për aktorë të ndryshëm, nga të cilat më të rëndësishmet janë:

GJYKATA SPECIALE E KOSOVËS duhet ta intensifikoj programin për shtrirjen e komunikimit dhe dialogut publik në Kosovë, Serbi dhe vendet e tjera në Ballkanin Perëndimor; ta rishqyrtojë krijimin e një pranie të përhershme të Dhomave të Specializuara në Kosovë; të sigurojë aktakuza dhe gjykime me kohë dhe efektive, në përputhje të plotë me ligjet në fuqi; dhe të shmangë çdo dyshim për ndikim politik ose paragjykim mbi vendimet dhe procedurat e GJSK-së.

QEVERTIA E KOSOVËS duhet të marrë përgjegjësi për GJSK-në si pjesë e sistemit ligjor të Kosovës dhe të bashkëpunojë plotësisht për të siguruar që të vendoset drejtësia për viktimat; të tregojë zotim të sinqertë në kërkesën e Komisionit Evropian për të zhvilluar një strategji gjithëpërfshirëse si pjesë e procesit të anëtarësimit në BE, duke investuar në një infrastrukturë për ballafaqimin me të kaluarën (IPBmK) në Kosovë, që e ka primatin në qasjet e përqendruara te viktimat dhe te të mbijetuarit, barazinë dhe ndjeshmërinë më të madhe gjinore, dhe de-etnizimin, de-politizimin, dhe de-personalizimin e iniciativave të BmK-së; Po ashtu duhet ta krijojë një komision parlamentar për ballafaqimin me të kaluarën që e ka për detyrë monitorimin dhe raportimin mbi progresin e qeverisë.

BE-ja DHE AKTORËT KYÇ NDËRKOMBËTARË NË KOSOVË duhet ta mbështesin një përpjekje të fuqishme dhe gjithëpërfshirëse për BmK-në në Kosovë duke investuar resurse politike, burokratike dhe financiare në promovimin e një kornize nacionale për ballafaqimin me të kaluarën; në mënyrë që Kosova t'i përmbushë kërkesat e Komisionit Evropian; ta monitorojnë progresin e Kosovës dhe të Serbisë në ballafaqimin me të kaluarën dhe në praktikat përfshirëse të drejtësia tranzicionale, në mënyrë eksplikite, si pjesë e procesit të tyre të anëtarësimit në BE. Po ashtu, dialogu i udhëhequr nga BE-ja për normalizimin e marrëdhënieve midis Serbisë dhe Kosovës duhet t'i adresojë çështjet e ngutshme dhe të pazgjidhura për ballafaqimin me të kaluarën.

SHOQËRIA CIVILE NË KOSOVË duhet të vazhdojë të punojë me ekipin e shtrirjes së komunikimit të GJSK-së për të arritur komunikim transparent dhe korrekt dhe shpërndarje të informacionit në shoqërinë e gjerë të Kosovës; dhe të punojnë së bashku në një koalicion për avancimin e një strategjie nacionale gjithëpërfshirëse për drejtësinë tranzicionale në Kosovë, përmes angazhimit me komunitete të ndryshme të viktimave, lob të përbashkët drejt qeverisë dhe aktorëve ndërkombëtarë, si dhe të investojë në fushata efektive dhe të qëndrueshme të komunikimit që i luftojnë narrativat nacionaliste dhe përjashtuese.

1. Parathënje

Në vitin 2015, Dhomat e Specializuara të Kosovës dhe Zyra e Prokurorit Special - të cilat së bashku njihen si Gjykata Speciale e Kosovës – janë krijuar për ta gjykuar një grup specifik të kimeve të pretenduara, të kryera nga anëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) gjatë dhe menjëherë pas konfliktit të dhunshëm në Kosovë të viteve 1998-1999. Gjykata funksionon sipas ligjit të Kosovës por është e vendosur në Hagë, Holandë, dhe është me staf tërësisht ndërkombëtar. Gjykata Speciale e Kosovës (GJSK) e ka një status kontradiktor në Kosovë: gjersa shumë njerëz në Kosovë janë pro drejtësisë për krimet e pretenduara, të kryera nga autorët e kimeve të njërs palë të Luftës në Kosovë, konsiderohet si e padrejtë dhe e pjesshme, veçanërisht nga popullata shqiptare e Kosovës. Gjersa qëllimi kryesor i GJSK-së është të vendosë drejtësi për rastet e kimeve të rënda, me standardet më të larta, puna e saj ka edhe ndikim më të gjerë shoqëror.

Në vitin 2017, PAX dhe Impunity Watch e kanë publikuar një studim që e vlerëson ndikimin e mundshëm të Gjykatës Speciale të Kosovës¹. Ai është bazuar në një analizë gjithëpërfshirëse të kontekstit shoqëror dhe politik dhe pozicioneve të palëve kryesore të përfshira për ta eksploruar ndikimin e mundshëm shoqëror të Gjykatës Speciale dhe për hartimin e strategjive lehtësuese. Nga ky studim doli se puna e GJSK-së mund të minohet rëndë nga kuptimi i kufizuar që e ka publiku për të, dhe kontestimi domethënës politik në Kosovë. Mesazhi kryesor që doli nga ky studim ishte «*Përdherisa Gjykata Speciale synon t'i mbajë përgjegjës autorët e kimeve të pretenduara, rreziqet e mundshme të këtij procesi mund të zvogëlohen vetëm nëse palët e përfshira, kosovare dhe ndërkombëtare e ndërmarrin një qasje të gjithëpërfshirjes shoqërore ndaj drejtësisë tranzicionale dhe ballafaqimit me të kaluarën. [...] Vetëm një zotim gjithëpërfshirës dhe i përtërirë nga të gjithë aktorët vendor, rajonal dhe ndërkombëtar mund të bëjë që ndikimet e padëshiruara të Gjykatës Speciale të mund të zvogëlohen e të zmadhohet potenciali i institucionit për të promovuar ndryshime pozitive shoqërore*» (f.9 / 10).

Paralelisht me këtë raport, PAX, INTEGRA, Impunity Watch dhe Qendra për Paqe dhe Tolerancë e kanë publikuar një studim gjithëpërfshirës të përceptimit të publikut në vitin 2017, për t'i marrë njohuritë, mendimet dhe pritet e qytetarëve mbi Gjykatën Speciale të Kosovës². Në atë kohë, GJSK ishte e themeluar për gati dy vjet dhe proceset përgatitore po vazhdonin. Studimi shpalosi se vetëdija e publikut për GJSK-në brenda Kosovës është e ulët, se ka të përhapura dezinformata dhe se pak njerëz besonin që GJSK-ja mund t'i mbrojë dëshmitarët dhe të vendosë drejtësi për viktimat. Janë bërë rekondime për palë të ndryshme të interesit, duke përfshirë edhe atë që GJSK të fillojë një program efektiv, të bazuar në dëshmi dhe që të ketë në shënjestë publikun e Kosovës, të përshtatur posaçërisht për anëtarët e komuniteteve të ndryshme të Kosovës, krahas krijimit të një pranie domethënëse në jetën publike të Kosovës, për të arritur vizibilitet dhe komunikim të dyanshëm për ta përmirësuar kuptimin dhe luftimin e dezinformatave. Për shkak se një gjykatë e kimeve të luftës është vetëm një mekanizëm - i rëndësishëm, por i kufizuar - për tu ballafaquar me të kaluarën, i

1 Visoka, Gëzim, 'Vlerësimi i ndikimit potencial të Gjykatës Speciale të Kosovës', shtator 2017, PAX & Impunity Watch: <https://www.paxforpeace.nl/publications/all-publications/assessing-the-potential-impact-of-the-kosovo-specialist-court>

2 Warren MJ et al., 'Përceptimi publik I Gjykatës Speciale të Kosovës: Rezjet e mundësitetë, shtator 2017, PAX, Impunity Watch, INTEGRA & CPT: <https://ngo-integra.org/publication/Perceptimi%20publik%20i%20Gjykat%C3%ABs%20Speciale%20t%C3%AB%20Kosov%C3%ABs.pdf>

është bërë thirrje Qeverisë së Kosovës për të investuar në resurse politike, burokratike dhe financiare, për promovimin e një kornize nationale për ballafaqimin me të trashëguarat e së kaluarës së luftës, që nevojiten për t'u ballafaquar në mënyrë më gjithëpërfshirëse me të kaluarën dhe për adresimin e shqetësimeve dhe nevojave më të gjera të komuniteteve të prekura.

Një kapitull i ri i funksionimit publik të GJSK-së filloj kur u paraqitet aktakuzat e para në Dhomat e Procedurës Paraprake, në prill të viti 2020, me konfirmimet pasuese ose shkarkimet (e pjesës së), që pritej të bëhen definitivë në fund të tetorit të vitit 2020. Kundrejt kësaj faze të re, PAX dhe INTEGRA e filluan një studim tjetër të përceptimit publik, të kryer në shtator të vitit 2020, për të hedhur dritë mbi përceptimet dhe kuptimet aktuale mbi GJSK-në në publikun e Kosovës. U është dhënë vëmendje edhe zhvillimeve të tjera në Kosovë që kanë të bëjnë me iniciativat e drejtësisë tranzicionale. Ngashëm me studimin e mëparshëm, të kryer në vitin 2017, është shqyrtuar konteksti më i gjerë politik dhe shoqëror i ballafaqimit me të kaluarën në Kosovë. Qëllimi kryesor i këtij studimi aktual është ta rishikojë rolin që GJSK e luan në një kontekst më të gjerë shoqëror dhe implikimet e saj për drejtësinë tranzicionale dhe transformimin pozitiv të shoqërisë në Kosovë.

Drejtësia tranzicionale

Drejtësia tranzicionale i referohet një sërë parimesh dhe mekanizmash për t'u ballafaquar me një të kaluar të dhunës në shkallë të gjerë dhe abuzimeve të mëdha të të drejtave të njeriut. Është një term gjithëpërfshirës që përfshin paradigmë të shumëfishta. Drejtësia tranzicionale zakonisht ndahet në katër shtylla kryesore: E drejta për drejtësi/ llogaridhënie; E drejta për të ditur/kërkuar të vërtetën; E drejta për dëmshpërbirim/ Drejtësia socio-ekonomike; dhe Garancitë për një reformë jo-përsëritëse/ institucionale dhe strukturore³. Qëllimet përfundimtare, afatgjata, të proceseve të drejtësisë tranzicionale e përfshijnë transformimin e konfliktit, parandalimin e përsëritjes dhe pajtimin. Shpesh, drejtësia tranzicionale kuptohet ngushtë se duhet të përqendrohet në drejtësinë e ndëshkimit për krime të rënda. Përderisa kjo është shpesh një komponent shumë i rëndësishëm për t'u ballafaquar me dhunën në shkallë të gjerë, ajo vetëm në një masë relativisht të vogël mund të vendosë drejtësi për viktimat dhe sigurisht nuk është e mjaftueshme për t'i transformuar shoqëritë dhe për ta arritur paqen e qëndrueshme.

Në një masë të madhe, një gjykatë ndërkombëtare si GJSK funksionon kryesisht në një mënyrë juridike dhe nuk mund të merret drejtpërdrejt me implikime më të gjera shoqërore përgjegjës vendosjes së drejtësisë që realizohet përmes procesit të rregullt ligjor dhe llogaridhënie për krime të rënda. Funksionimi i hetimeve penale dhe procedimeve gjyqësore pasuese duhet të ndodhë në përputhje me zbatimin e ligjit, të ndarë nga politika ose dinamika e gjerë shoqërore. Sidoqoftë, themelimi i GJSK-së - krahas konsideratave juridike – është edhe një vendim politik dhe funksionimi dhe rezultatet e saj janë të prirura për të krijuar ndikime të menjëhershme dhe të gjera për shoqërinë e Kosovës.

³ Për një elobarim të konceptit të Drejtësisë Tranzicionale/ Ballafaqimit me të Kaluarën, shihni reportet 'Essential' nga Swisspeace; 02/2016: <https://www.swisspeace.ch/publications/essentials/a-conceptual-framework-for-dealing-with-the-past> dhe 04/2017: <https://www.swisspeace.ch/publications/essentials/from-transitional-justice-to-dealing-with-the-past-the-role-of-norms-in-international-peace-mediation>

Gjatë njëzet e një viteve të fundit, janë krijuar iniciativa dhe mekanizma tjerë për tu marrë me të trashëguarata nga lufta. Disa organizata të shoqërisë civile u angazhuan në dokumentim, monitorimin e gjykimeve të krimave të luftës, mbështetjen e grupeve të viktimateve, ndarjen e rrëfimeve të ndryshme për kohën e luftës, promovimin e të drejtave të viktimateve dhe ndërtimin e paqes. Sidoqoftë, shumica e tyre nuk kanë qenë në atë shkallë për ta prekur shoqërinë e gjerë. Fatkeqësisht, nisma për një komision rajonal të së vërtetës (KOMRA) ka ngetur. Investimi më i madh institucional në Kosovë ishte krijimi i Grupit Punues Ndërministror (2012) për Ballafaqim me të Kaluarën dhe Pajtim, i cili përfundoi pa sukses katër vite më vonë. Ish Presidenti Thaçi e nisi idenë për ta krijuar një Komision të së Vërtetës dhe Pajtimit (KVP) për Kosovën në vitin 2017, përderisa tashmë vetë ishte në listën e të dyshuarve të GJSK-së. Ekipi përgatitor për krijimin e KVP-së përparoi mirë, gjersa përballej me mosbesim për shkak të patronit të tij⁴. «*nga mungesa e koordinimit dhe harmonizimit, politizimit dhe personalizimit nga udhëheqësit politikë, dhe më e rëndësishmja, nuk arriti të sigurojë përfaqësim adekuat dhe përfshirje të komuniteteve të prekura (viktimat dhe të mbijetuarit e konfliktit)*»⁵.

Në këtë kontekst, mund të nxirret përfundimi nga të gjeturat e këtij studimi, se pa një investim më të gjerë në drejtësinë tranzicionale dhe ballafaqimin me të kaluarën në Kosovë, GJSK rezikon të përceptohet si mekanizmi i vetëm për ballafaqimin me abuzimet e së kaluarës në Kosovë, duke vënë në hipe raste tjera të rëndësishme, çështje të trashëguara dhe çështje të pazgjidhura të luftës që kanë një rol po aq të rëndësishëm për shoqërinë kosovare.

METODOLOGJIA

Të dhënat e prezantuara në këtë raport bazohen në hulumtimet në tavolinë dhe në një anketë të kryer me qytetarët e Kosovës. Hulumtimi në tavolinë i analizon artikuj akademikë, artikuj e mediave dhe deklaratat publike mbi, ose që kanë të bëjnë me GJSK-në, që nga viti 2015. Studimi i përceptimit u krye në mes të shtatorit të vitit 2020 duke e përdorur «sondazhin omnibus» nga UBO Consultancy⁶. Ky është një studim periodik i dedikuar për mbledhjen e informacionit mbi temat e ndryshme, pjesë e të cilit ishte studimi për përceptimet mbi GJSK-në, përmes një studimi të përbashkët gjithëpërfshirës. Ai është administruar në 38 komuna të Kosovës dhe përfshinë gjithsej 1.065 qytetarë të Kosovës mbi 18 vjeç, të ndarë në tri nën-mostra: 815 intervista me shqiptarë të Kosovës, 150 intervista me serbë të Kosovës dhe 100 intervista me të tjerë të Kosovë (me pakicat jo-serbe). Dy grupet e fundit janë të mbi-mostruara për të lejuar një analizë më të besueshme në nivelin etnik. Mostra ponderohet në mënyrë adekuate para se të kryhet analiza në mënyrë që ta pasqyrojë strukturën etnike të Kosovës. Përderisa kjo metodë ofron të dhëna të besueshme për perceptimet midis qytetarëve të Kosovës, përceptimet e kosovarëve që jetojnë jashtë nuk ishin pjesë e studimit. Para se të përdorej pyetësori, ai u testua në terren për t'i identifikuar problemet logjike dhe substancile. Studimi mbi perceptimet mbi Gjykatën Speciale të Kosovës është një version i përshtatur i atij të vitit 2017. Pas përfundimit të punës në terren, të dhënat u eksportuan në një set të dhënave SPSS për pastrim, kodim të përgjigjeve dhe analiza.

PËRMBLEDHJE E RAPORTIT

Së pari, rapporti e jep historikun e origjinës së GJSK-së, i diskuton kritikat mbi të dhe i thekson zhvillimet e fundit. Pastaj, prezantohen të gjeturat nga studimi i përceptimit i vitit 2020 mbi GJSK-në. Në fund, janë nxjerrë përfundimet dhe rekomandimet e formuluara për aktorë të ndryshëm.

⁴ Integra dhe Iniciativa e Re Sociale (NSI), 'Matja e perceptimit publik, dhe dialogu publik, për Komisionin e ardhshëm për të Vërtetën dhe Pajtimin (KVP) në Kosovë', 2020; https://ngo-integra.org/publication/Perception_Survey_KS-%20final%20ALB.pdf

⁵ Visoka, Gëzim & Besart Lumi, 'Demokratizimi i Drejtësisë Tranzicionale - Drejt një Infrastrukturë Diskutuese për Trajtimin e së Kaluarës në Kosovë', PAX, Integra & NSI (Qershor 2020); https://ngo-integra.org/publication/Demokratizimi%20%20Drejtësia%20Tranzicionale_June2020_print_3mm_bleed.pdf

⁶ Për më shumë informata: <http://www.uboconsulting.com/omnibus.html>

2. Origjina, sfidat dhe zh- villimet rreth Gjykatës Speciale të Kosovës

2.1 Lufta në Kosovë dhe ndjekja penale e krimeve të luftës

Lufta në Kosovë ishte episodi i fundit i dhunshëm i shpërbërjes së ish-Jugosllavisë. Lufta filloj më 20 mars, 1998 me ofensivën e ushtrisë serbe/ jugosllave kundër Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) në Kosovë⁷. Lufta e pasoi një periudhë shumë më të gjatë, në të cilën tensionet në mes të shqiptarëve dhe serbëve në Kosovë ishin rritur për shkak të diskriminimit strukturor të popullsisë shqiptare, veçanërisht që nga viti 1989. UÇK-ja u zhvillua nga grupe të lira, të shpërndara guerile nga fundi i viteve 1980 në një lëvizje të armatosur nga mesi i viteve 1990. UÇK-ja nuk e ndoqi rezistencën e padhunshme të Ibrahim Rugovës, udhëheqësit politik të Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) dhe presidentit të shtetit paralel të Kosovës në atë kohë, kundër dominimit dhe diskriminimit serb. Lufta e Kosovës zgjati deri në qershori 1999, kur Marrëveshja e Kumanovës i përfundoi luftimet⁸. Kjo marrëveshje nuk ishte marrëveshje paqësore në mes të kundërshtarëve kryesorë, Serbisë dhe UÇK-së, por një marrëveshje ushtarake e nënshkruar në mes të Forcës Ndërkombëtare të Sigurisë së NATO-s (KFOR) dhe Qeverive të Republikës Federale të Jugosllavisë dhe Republikës së Serbisë, e cila i dha fund bombardimeve të NATO-s në Serbi dhe hapi rrugën për një administratë të OKB-së në Kosovë. Lufta kishte rezultuar në më shumë se 80 përqind të të gjithë popullsisë së Kosovës, dhe 90 përqind të shqiptarëve të Kosovës, të zhvendosur nga shtëpitë e tyre; më shumë se 863.000 shqiptarë etnikë u larguan nga Kosova⁹. Forcat serbe kryen masakra të shumta, në të gjithë Kosovën, dhe kudo kishte shkatërrim të pronës civile nga qeveria Jugosllave dhe trupat serbe. Gjatë luftës, UÇK-ja gjithashtu bëri abuzime serioze, duke përfshirë vrasje,

⁷ Nën federatën jugosllave (1942-1992) Kosova ka qenë krahinë autonome, Krahina Autonome e Kosovës dhe Metohisë, brenda republikës konstitutive jugosllave të Serbisë deri në vitin 1989, kur Milosheviçi e revokoi statusin e saj të autonomisë si pjesë e një plani më të madh për ta bërë Kosovën si pjesë të Serbisë së plotë.

⁸ Për një përkthim të hollësishëm të Luftës në Kosovë dhe krimeve të kryera nga forcat qeveritare serbe dhe jugosllave, Ushtria Çlirimtare e Kosovës dhe NATO, shih: Human Right Watch, 'Nën urdhëra: Krimet e luftës në Kosovë', 2001: <https://www.hrw.org/reports/2001/kosovo/>

⁹ HRW (2001).

rrëmbime dhe dëbime të civilëve serbë, ose shqiptarëve që konsideroheshin si bashkëpunëtorë të shtetit jugosllav. Më shumë se 220,000 serbë u larguan nga Kosova gjatë luftës dhe menjëherë pas luftës¹⁰. Gjithsej, 13,535 persona u vranë ose u zhdukën ne mes të martsit 1998 dhe fundit të vitit 2000; mes tyre 10,812 shqiptarë, 2,197 serbë dhe 526 anëtarë të bashkësive të tjera etnike (romë, ashkalinj, egjiptianë, boshnjakë, etj.), shumica e të cilëve civilë¹¹. Menjëherë pas luftës, u kryen shkelje të tjera serioze të të drejtave të njeriut, veçanërisht kime hakmarrëse nga UÇK-ja ndaj bashkëpunëtorëve ose kundërshtarëve politikë (të përceptuar). Menjëherë pas luftës, në mes të 10 qershorit dhe 31 dhjetorit të vitit 1999, 1,306 persona u vranë; 715 serbë, 318 shqiptarë dhe 273 anëtarë të bashkësive të tjera etnike¹². Që në vitin 1999, dolën në pah disa informacione rreth rrëmbimeve dhe kampeve të pretenduara të paraburgimit, të drejtuara nga UÇK-ja në veri të Shqipërisë¹³.

Pas përfundimit të Luftës në Kosovës, Kosova u bë një protektorat de-facto nën Misionin e Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), me një mandat të qeverisjes së përkohshme, ndihmës humanitare, rindërtimit dhe ndërtimit të shtetit. Në vitin 2002, pasi LDK i fitoi zgjedhjet, Ibrahim Rugova u zgjodh President. Për pjesën më të madhe të periudhës pas vitit 1999, tensionet në mes të fraksioneve të ndryshme të shqiptarëve të Kosovës u shndërruan në konflikt politik ndëretnik në mes të fraksioneve politike rivale. Krahas LDK-së, kryesore ishin ato që u zhvilluan nga UÇK-ja; Partia Demokratike e Kosovës (PDK), për një periudhë të gjatë e udhëhequr nga Hashim Thaçi; Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), e udhëhequr nga Ramush Haradinaj dhe Nisma Socialdemokrate (NISMA), e formuar nga Fatmir Limaj dhe Jakup Krasniqi¹⁴. Në vitin 2008, nën Presidentin Fatmir Sejdiu dhe Kryeministrin Hashim Thaçi, Kosova e shpalli pavarësinë e saj nga Serbia, e cila u njoh nga 113 nga gjithsej 193 shtete anëtare të OKB-së.¹⁵

Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavi (TPNJ) është themeluar në vitin 1993 për t'i ndjekur penalisht krimet e rënda të kryera gjatë Luftërave Jugosllave (1991-1999) dhe ishte operativ deri në vitin 2017¹⁶. Në mes të viteve 2007 dhe 2014, TPNJ-ja ndoqi penalisht edhe kime të rënda të kryera në Kosovë; me dy raste kundër forcave dhe politikanëve jugosllavë/serbë (tetë individë; pesë të dënuar) dhe dy raste kundër komandantëve të rangut të lartë të UÇK-së (gjashtë individë; një i dënuar)¹⁷. Si me të gjitha krimet e luftës dhe rastet e tjera të kimeve të rënda, hetimet dhe gjykimet morën shumë vite për t'u përfunduar. Procedimet e TPNJ-së krijuan një mori faktesh rreth luftërave jugosllave, dënuan autorë të kimeve të rangut të lartë, vendosën një nivel të drejtësisë për disa grupe viktimash dhe ajo njihet gjëreshisht për rolin e saj në përparimin e drejtësisë ndërkombëtare. Megjithatë, edhe në sytë e ekspertëve ligjor të përfshirë drejtpërdrejt, TPNJ, “në kundërshtim me atë që pritej, nuk i ka ndryshuar narrativat ekzistuese, shpesh mohuese,

10 Po aty.

11 Fondi për të Drejtën Humanitare (FDH), *Libër kujtimi i Kosovës*, Prishtinë, 2011; <http://www.kosovomemorybook.org>

12 Po aty.

13 Shih: Misioni Verifikues i OSBE-së, *Të drejtat e njeriut në Kosovë: Si është parë, është thënë. Vëllimi I*, tetor 1998 - qershori 1999; <https://www.osce.org/odihr/17772>, dhe *Të drejtat e njeriut në Kosovë: Si është parë, është thënë. Vëllimi II*, 14 qershori - 31 tetor, 1999, (5 nëntor, 1999); <https://www.osce.org/kosovo/17781>; Human Rights Watch (2001); Balkan Insight: <https://balkaninsight.com/2009/04/16/unlocking-the-dark-secrets-of-the-kla-s-camps/> dhe Balkan Insight, ‘Trafikimi i organeve në Kosovë: Si u eksposuan pretendimet’, 4 shtator, 2015: <https://balkaninsight.com/2015/09/04/kosovo-organ-trafficking-how-the-claims-were-exposed-09-04-2015-1/>

14 Covey, J., Dziedzic, M. & Hawley, L. (Eds.), *Kërkimi i pages së qëndrueshme: intervenimi ndërkombëtar dhe strategjitet për transformimin e konfliktit*, USIP, 2005: <https://www.usip.org/publications/2005/05/quest-viable-peace#:~:text=As%20the%20editors%20of%20this,means%20for%20continued%20violent%20conflict>

15 Numri i saktë i vendeve ose shteteve anëtare të OKB-së që e njohin pavarësinë e Kosovës është kontestuar në vitin 2020 (pretendimet varirojnë midis 100-116 vendeve) pasi disa prej tyre e kanë revokuar atë vendim, megjithëse statusi ligjor i vendimeve të tilla është i paqartë; <https://www.polgeonow.com/2020/09/which-countries-recognize-kosovo-independence.html>

16 Që nga vit 2017 rastet e vazhdueshme të TPNJ-së u morën nga Mekanizmi i Mbetur për Tribunalet Penale.

17 Shih Tribunalin Penal Ndërkombëtar të Kombeve të Bashkuara për ish Jugosllavinë: <https://www.icty.org/en/cases/key-figures-cases>

në lidhje me konfliktin, dhunën dhe krimet e viteve të 1990-ta në rajon «¹⁸

Pretendimet rreth kampeve të paraburgimit të drejtuara nga UÇK ishin hetuar gjithashtu nga TPNJ-ja, ashtu siç u shpalos nga Carla del Ponte, një ish-kryeprokurore e TPNJ-së (1999-2007), në memoaret e saj. Në to, ajo pretendoi se hetimet e TPNJ-së kishin rezultuar, me baza serioze, për të besuar se individët e UÇK-së kishin kryer kime të rënda kundër serbëve, pakicave të tjera dhe shqiptarëve, përfshirë trafikimin e organeve njerëzore¹⁹. Megjithëse TPNJ-ja ishte përballur me sfida të shumta gjatë hetimeve dhe përfundimisht nuk kishte prova të mjaftueshme për të ndjekur penalisht, sipas Del Pontes. Përderisa ajo u kritikua për shpalosjen e këtij informacioni, ky informacion e siguroi bazën që Komiteti për Çështje Ligjore dhe të Drejta të Njeriut i Këshillit të Evropës të kërkonte hetime më të detajuara për pretendimet dhe shkeljet e të drejtave të njeriut të përshkruara në librin e saj.

Dick Marty, raportuesi për Komisionin e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës për Çështje Ligjore, u ngarkua të merrej me këtë hetim jo-kriminal gjatë viteve 2009 dhe 2010. Gjithashtu në vitin 2009, gazetari që shkruajti për kampet e paraburgimit të UÇK-së në vitin 1999, e lëshoi një podcast me këtë temë, duke i përfshirë dëshmitë e dëshmitarëve okularë²⁰. Studimi i Marty përfundimisht rezultoi në raportin e Këshillit të Evropës ‹Trajtimi Çnjerëzor i Njerëzve dhe Trafikimi i Paligjshëm i Organeve Njerëzore në Kosovë› («Raporti i Marty»), i cili u miratua nga Këshilli më 7 janar, 2011²¹. Raporti shpalosi se raportet e mëparshme për krimet nuk ishin hetuar ose dokumentuar si duhet dhe se «*organizatat ndërkombëtare të vendosura në Kosovë e kanë favorizuar një qasje pragmatike politike, me pikëpamjen se ato kishin nevojë ta promovonin stabilitetin afatshkurtër me çdo çmim, duke i sakrifikuar kështu disa parime të rëndësishme të drejtësisë*»²². Në Kosovë, raporti u refuzua masivisht nga elitat politike të cilat ishin të implikuara. Kryeministri i atëhershëm Thaçi e quajti atë «*shpifje skandaloze*» që synonte ndalimin e Kosovës për t'u bërë një vend i pavarur, plotësisht i njohur dhe shtet anëtar i BE-së²³. Raporti i Marty rekomandoi që EULEX t'i vazhdojë hetimet penale në pretendime të vërtetuar, me mbështetjen e plotë të BE-së dhe shteteve anëtare. Më pas, një Task Forcë Speciale Hetuese (TFSH) u instalua në vitin 2011 nga BE-ja, me mbështetjen e Shteteve të Bashkuara, «*për të hetuar dhe, nëse justifikohet, për të ndjekur penalisht individë*», për abuzimet e dhunshme të pretenduara në Raportin e Marty.

Që nga viti 2000, dhe krahas gjykimeve të TPNJ-së, janë ndjekur edhe hetimet e brendshme për krimet e luftës në Kosovë²⁴. Së pari nën administrimin e UNMIK-ut, i cili e ka përdorur një model hibrid të një sistemi gjyqësor të mandatuar nga OKB-ja në Kosovë me një juridiksion të kimeve të luftës, deri në pavarësinë e Kosovës në vitin 2008. Nga ajo kohë, gjykatat e Republikës së Kosovës e morën përsipër ndjekjen penale

18 Gjyqtarja Christine van den Wyngaert, e cila ka shërbyer si gjyqtare në TPNJ and GIPN dhe është emëruar në listën e gjyqtarëve në Dhomat e Specializuara të Kosovës, të cituar në: Qendra për Drejtësi Penale Ndërkombëtare / Vrije Universiteit, 'Drejtësia Penale Ndërkombëtare në udhëkryq: Reflektimi mbi të kaluarën, diskutimi mbi të ardhmen dhe imaginimi i së ardhmes', shënim konferencash, maj 2019: <https://cicj.org/events/conferences/international-criminal-justice-at-the-crossroads/>

19 Për këto pretendime, shih për shembull: <https://www.rferl.org/a/1109621.html>. Libri i Carla del Ponte & Chuck Sudetic, *La caccia: Io e i criminali di guerra* është botuar në prill, 2008. Versioni në anglisht: *Madame Prosecutor: Confrontations With Humanity's Worst Criminals and the Culture of Impunity*, Other Press, 2009.

20 BBC Radio 4, 'Kalimi i kontinenteve: Kosovë, shpalosen tmerret e kampeve të burgjeve të UÇK-së', 10 prill, 2009; <http://news.bbc.co.uk/2/hi/europe/7990984.stm>

21 Këshilli i Evropës, Komisioni për Çështje Ligjore dhe të Drejta të Njeriut, Trajtimi Çnjerëzor i Njerëzve dhe Trafikimi i Paligjshëm i Organeve Njerëzore në Kosovë, Report Doc. 12462, 12 dhjetor, 2010; <http://www.assembly.coe.int/committeedocs/2010/ajdoc462010prov.pdf>

22 Raporti i Marty (2010).

23 EU Observer, 'Intervista me kryeministrin e Kosovës: rapporti për trafikim të organeve është "shpifje monstruoze"', 10 janar, 2011; <https://euobserver.com/foreign/31613>

24 Si dhe në Serbi, për detaje mbi gjykimet e brendshme të Serbisë për krimet e luftës shih: Fondi për të Drejtën Humanitare. 'Gjykimet e kimeve të luftës në Serbi': <http://www.hlc-rdc.org/?cat=292&lang=de>

të kimeve të luftës, të plotësuar me një organ gjyqësor të mandatuar nga BE-ja për t'i ndjekur penalisht krimet e luftës; Misioni i BE-së për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX). Gjyqtarët dhe prokurorët e EULEX-it kanë funksionuar brenda sistemit të prokurorisë dhe gjykatave të Kosovës, por kanë operuar si të pavarur në përgjedhjen e rasteve. Përderisa UNMIK-u i kishte identifikuar pothuajse 1,200 kime potenciale të luftës²⁵, për vetëm dhjetë raste (23 individë) u ngritën aktakuza me viteve 2000 dhe 2008. EULEX-i e mori përsipër këtë ngarkesë të rëndë të rasteve, të pothuajse 1200 kimeve të luftës. Deri në vitin 2014, ai i kishte përbyllur 500 raste për shkak të mungesës së dëshmive, ndërsa 600 raste ishin në pritje dhe 51 raste të reja të kimeve të luftës ishin iniciuar²⁶. Nga viti 2009 deri në vitin 2018, EULEX-i arrii të ngrëjë aktakuza në vetëm 22 raste (52 individë)²⁷. Të paktën një e treta e këtyre përfshinte autorë të dyshuar të kimeve, të përkatisës etnike serbe. Por siç kishte theksuar një Shef i Misionit të EULEX-it *"shumica e të dyshuarve për kime luftë, për kime të kryera kundër shqiptarëve të Kosovës gjatë luftës, janë serbë të Kosovës, ose shtetas serbë. Por ata nuk janë më në Kosovë. Gjyqësori i Kosovës (përfshirë edhe EULEX-in) mund të kryejë hetime kundër autorëve të dyshuar të kimeve, por ka juridiksim vetëm në Kosovë. (...) Askush nuk mund të gjykohet në mungesë."*²⁸

Raste të tjera të kimeve të luftës përfshinin ish-luftëtarë të UÇK-së të akuzuar për kime të pretenduara në Raportin e Marty, si dënimet e anëtarëve të UÇK-së 'Grupi Drenica' për kime kundër civilëve në një qendër paraburgimi në veri të Kosovës²⁹. Nga viti 2012, misioni i EULEX-it u zgjodhua gradualisht dhe deri në vitin 2014 e kishte transferuar shumicën e kompetencave të tij për krimet e luftës te gjykatat dhe prokurorët e Kosovës. Në katër vitet në vijim, prokurorët vendorë i ngritën tri raste të kimeve të luftës.³⁰

TFSH-ja i zhvilloi hetimet e saj në bashkëpunim me EULEX-in nga shtatori i vitit 2011 deri në vitin 2014. Kah mesi i vitit 2014 njoftoi se ishin mbledhur dëshmi të mjaftueshme për të ngritisht aktakuzë kundër zyrtarëve të lartë të UÇK-së të cilët «mbajnë përgjegjësi për fushatën e persekutimit që ishte drejtuar kundër serbëve etnikë, romëve dhe popullatës tjetër pakicë të Kosovës dhe ndaj shqiptarëve të Kosovës, të cilët ata i etiketuan si bashkëpunëtorë të serbëve ose më shpesh që thjesht kanë qenë kundërshtarë politik të udhëheqjes së UÇK-së »³¹. Për përfshirjen e pretenduar të UÇK-së në trafikimin e organeve njerëzore nuk ishte siguruar asnjë dëshmi përfundimtare. Me këto të gjetura të parezistueshme, hapi tjetër ishte gjetja ose ngritja e një organi institucional që mund t'i ndjekë penalisht këto kime të pretenduara. TPNI-ja paraprakisht i kishte hedhur hetimet e mëtejshme në lidhje me krimet e pretenduara të UÇK-së dhe statuti i TPNI-së parashikonte që krimet kundër njerëzimit mund të hetoheshin vetëm nëse ato kanë ndodhur gjatë konfliktit të armatosur, gjë që e bëri të vështirë për gjykatën që t'i ndjekë penalisht krimet kundër njerëzimit,

25 Muharremi, Robert, "Dhomat e Specializuara të Kosovës nga një perspektivë e realizmit politik", Zhurnal Ndërkombëtar i Drejtësisë Tranzicionale, (2019:13):

290–309.

26 Artikull nga Bernd Borchardt, Shef i Misionit të EULEX-it 2013/2014, 'EULEX-i dhe krimet e luftës', pa datë; <https://www.eulex-kosovo.eu/en/news/000427.php>

27 Fondi për të Drejtëni Humanitar (FDH) Kosovë, një përbledhje e gjykimeve të kimeve të luftës në Kosovë në periudhën 1999-2018, Prishtinë, tetor 2018.

28 Bernd Borchardt; fusnota 23.

29 Shih Balkan Insight; Ish-luftëtarët e UÇK-së ndalojnë për kime në Shqipëri; 8 tetor, 2015; <https://balkaninsight.com/2015/10/08/kosovo-detains-ex-kla-fighter-for-war-crimes-10-08-2015/> and: 'Konfirmohen aktakuzat për guerilët e 'Grupit Drenica'; 4 shtator, 2017; <https://balkaninsight.com/2017/09/04/kosovo-drenica-group-supreme-court-verdict-09-04-2017/>

30 FDH Kosovë (tetor, 2018).

31 Rrjeti Hulumtues i Ballkanit (BIRN), *Dhomat e Specializuara të Kosovës: Nga hetimet në aktakuza*, 2017. E-book: <https://balkaninsight.com/2017/11/01/birn-publishes-kosovo-war-crimes-court-e-book-10-30-2017/>

të kryera pas qershorit të vitit 1999³². Për më tepër, TPNJ-ja do t'i ndalte operimet e saj në vitin 2014. EULEX-i nuk kishte treguar përparim thelbësor në ndjekjet penale të krimeve të luftës dhe kishte rënje. Progresi i kufizuar i EULEX-it ishte edhe rezultat i «nevojës së tyre për ta shmangur prishjen e stabilitetit politik»³³. Gjykatat vendase nuk e kishin kapacitetin e duhur dhe me gjasë do të duhej të përballeshin me ndërhyrje të mëdha politike. Një shqetësim në gjykimet vendase ishte edhe mbrojtja e dëshmitarëve; të gjitha hetimet nga TPNJ-ja, UNMIK-u, EULEX-i dhe TFSH-ja kishin përfjetuar kërcënime të dëshmitarëve³⁴. Në këtë mënyrë, u konkludua që duhej të zhvillohej një organ i ri i prokurorisë dhe gjykatës.

Në vitin 2014, BE-ja dhe SHBA-ja zyrtarisht kërkuan që Kosova ta pranojë krijimin e një gjykate ndërkombëtare hibrilde për t'i hetuar pretendimet e bëra në Raportin e Marty dhe të konfirmuara nga TFSH-ja. Projektimi i modaliteteve të gjykatës u bë nga Shërbimi i Jashtëm i BE-së (EEAS), dhe pastaj pasoi shkëmbimi diplomatik në mes të zyrtarëve të BE-së dhe institucioneve të Kosovës³⁵. Kuvendi i Kosovës e ratifikoi këtë shkëmbim letrash për themelimin e gjykatës speciale si një marrëveshje ndërkombëtare, duke e bërë kështu Kosovën që të zotohet për të³⁶. Ajo u miratua nga 89 vota parlamentare pro dhe 22 kundër, megjithëse Kryeministri i atëhershëm Hashim Thaçi e quajti atë «padrejtësinë dhe fyerjen më të madhe që mund t'i bëhej Kosovës dhe popullit të saj»³⁷. Në të njëjtin vit, gjykata speciale u përfshi edhe nga Komisioni Evropian si një obligim sipas Strategjisë së Zgjerimit për Kosovën, duke e bërë kështu krijimin e saj një kriter të anëtarësimit për Kosovën. Kushtëzimi i tillë ishte zbatuar edhe për krijimin e TPNJ-së për ta siguruar bashkëpunimin nga shtetet e ish-Jugosllavisë³⁸. Me anëtarësimin në BE si një prioritet i lartë për Republikën e Kosovës, ekzistonte një besim i madh se Kosova do ta përmbushte këtë kusht. Në dhjetor të vitit 2014, Këshilli i BE-së iu referua këtij zotimi dhe i bëri thirrje Kosovës që ta themelojë Gjykatën Speciale³⁹.

Që gjykata e re të funksiononte sipas ligjit të Kosovës, ishte i nevojshëm një ndryshim kushtetues që do të lejonte që ligji për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit Special të miratohet nga Kuvendi i Kosovës. Në Kosovë, kjo nuk ndodhi lehtë, me debate të nxehta në parlament për muaj me radhë dhe protesta në rrugë kundër legjislacionit që do të vinte në gjyq luftëtarët e UÇK-së⁴⁰. Votimi ishte caktuar dhe anuluar disa herë në Kuvendin e Kosovës. Votimi i parë faktik në korrik të vitit 2015 nuk mori mjaft vota. Megjithëse u bë presion mbi neverinë e Kosovës përmes paralajmërimive të përsëritura se Këshilli i Sigurimit i OKB-së do ta formonte

32 Sidoqoftë, Holvoet argumenton se ky kufizim i statutit të TPNJ-së nuk ishte i pakapërcyeshëm, por që opzioni që TPNJ t'i hetojë më tej krimet e pretenduara nuk u shqyrtua seriozisht. "Për më tepër, edhe nga këndvështrimi i ekonomisë gjyqësore, duket se TPNJ-ja do të kishte qenë një institucion i pajisur mirë për t'i ndjekur penalish krimet e pasluftës së UÇK-së": Holvoet, M., 'Rëndësia e vazhdueshme e modelit të drejtësisë hibride ose të ndërkombëtarizuar: Çështja e Dhomave të Specializuara të Kosovës', Forumi i Ligjit Penal (2017) 28:35–73; f. 45.

33 Calpin, S. & G.D. Crossley 'EULEX: Anti-korrupsioni dhe kufizimet e një vlerësimi sasior', Lëvizja FOL (2016); <http://levizjafol.org/folnew/wp-content/uploads/2016/02/EULEX-EN.pdf>

34 Karadaku, Linda, 'Kosova premton bashkëpunimin në hetimin e krimeve të luftës', Southeast European Times, 6 gusht, 2014, marrë nga: <https://atlanticinitiative.org/kosovo-promises-to-cooperate-with-war-crimes-investigation/>

35 Korenica, F., Zhubi, A. & Doli, D., 'Gjykata e specializuar hibride dhe ndërkombëtare e inxhinieruar nga BE-ja në Kosovë: Sa 'speciale' është? Rishikimi i së Drejtës Kushtetuese Evropiane, 12 (2016): 474–498.

36 Ligji për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare ("Shkëmbimi i letrave"), 23 prill, 2014; https://www.scp-ks.org/sites/default/files/public/04-l-274_a.pdf

37 BIRN e-book (2017), f.171 (artikulli, 24 prill, 2014).

38 Vështrime nga Kryeprokurori i TPNJ-së Serge Brammertz, Tribunali Ndërkombëtar dhe përtej: ndjekja e drejtësisë përmizoritë në Ballkanin Perëndimor, në konferencën e përbashkët të Komisionit përmis Drejtësia e Njeriut 'Tom Lantos' dhe Komisionit përmis Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, 12 dhjetor, 2017.

39 Korenica et al (2016).

40 Balkan Insight, 'Gjykata e re e luftës në Kosovë: si do të funksionojë?', 6 gusht, 2015; <https://balkaninsight.com/2015/08/06/how-will-special-kosovo-court-work-08-05-2015/>

gjykatën nëse Kosova nuk e bën këtë vetë.⁴¹ Në gusht të vitit 2015, Parlamenti i Kosovës votoi në favor të ndryshimit kushtetues dhe miratimit të Ligjit për Dhomat e Specializuara. Zyra e BE-së, ambasadat e BE-së dhe Ambasada e SHBA-së në Prishtinë e mirëpritën këtë arritje pasi ajo do ta «*forconte parimin e sundimit të ligjit në Kosovë*» dhe “*me ballafaqimin me të kaluarën e saj dhe vendosjen e drejtësisë përviktimat, Kosova mund të arrijë pajtimin dhe ndërtimin e një të ardhme më të mirë.*”⁴²

Dhomat e Specializuara të Kosovës dhe Zyra e Prokurorit Special (GJSK) e kanë «*një mandat dhe juridikcion specifik mbi krimet kundër njerëzimit, krimet e luftës dhe kime tjera sipas ligjit të Kosovës, të cilat kishin filluar ose ishin kryer në Kosovë, në mes të 1 janarit 1998 dhe 31 dhjetorit 2000 nga ose kundër shtetasve të Kosovës ose Republikës Federale të Jugosllavisë*»⁴³. Kjo do të thotë se ajo i heton dhe mund të ndjekë penalisht individë, për të cilët pretendohet se kanë kryer krimet në Kosovë ose që kanë filluar krimet nga Kosova (të kryera në një territor tjetër) gjatë viteve 1998-2000, kundër qytetarëve nga Kosova ose Republika Federale e Jugosllavisë⁴⁴. Asnjë person nuk do të gjyket para Dhomave të Specializuara përvaprë që janë gjykuar tashmë nga TPNJ-ja ose ndonjë gjykatë e Kosovës⁴⁵. Askund në mandatin e GJSRK-së nuk thuhet se ajo i heton ose i ndjekë penalisht vetëm ish-anëtarët e UÇK-së. Sidoqoftë, ZPS-ja duke qenë vazhdimësi e TFSH-së me mandat përvaprëtëhet individë përkrimet e pretenduara në Raportin e Marty, që mbulonte vetëm krimet të pretenduara të kryera nga anëtarët e UÇK-së, nuk ka shumë të ngjarë se autorët tjerë të krimave do të ndiqen penalisht nga GJSK-ja. Në shumë raste, prokurorët kanë theksuar se vetë UÇK-ja nuk është në shënjestë, por individët që kanë kryer krimet të rëndë; «*Unë nuk jam duke i ndjekur organizatat, nuk jam duke i ndjekur grupet etnike, unë jam duke kërkuar përgjegjësi individuale për atë që është bërë*» kishe argumentuar në vitin 2016 prokurori i atëhershëm i GJSK-së David Schwendiman.⁴⁶

Fakti që mandati e përfshinë periudhën deri në fund të vitit 2000 ndërsa lufta përfundoi në qershor të vitit 1999, e konfirmon përfshirjen e krimave të pasluftës, por është mjaft unike për gjykatat e krimave të luftës, pasi përvaprëtëhet individë përkrimet e luftës edhe krimet e përgjithshme, të motivuara politikisht, duke e zgjeruar kështu juridikcionin, në krahasim me atë të gjykatave tjera ndërkombëtare të krimave të luftës⁴⁷. Përderisa Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit janë të natyrës së përkohshme, përfundimi i tyre kushtëzohet nga një njoftim zyrtar nga BE. Fillimisht, operimet e GJSK-së ishin parashikuar përvaprëtëhet individët që t'i shtirjë procedurat e GJSK-së përvaprëtëhet kësaj periudhe. Edhe pse deputetët e Kuvendit të Kosovës janë përpjekur disa herë të argumentojnë se viti 2020 është viti i fundit përvaprëtëhet individët tashmë ka treguar se nuk është ashtu.

41 Prishtina Insight, korrik, 2015 <https://prishtinainsight.com/mps-to-vote-again-on-special-court/> dhe; ish-prokurori i TFSH-së, Williamson konfirmoi se Rusia, në veçanti, e donte një gjykatë të OKB-së dhe se nëse BE-ja dhe SHBA-ja nuk do të hetonin më tej, kishte të ngjarë që një gjykatë e OKB-së të kalonte në Këshillin Sigurimit: RTK Live, ‘Williamson: nëse Kosova nuk do ta formonte Gjykatën Speciale, këtë do ta bënte OKB-ja’, 16 nëntor, 2020; <https://www.rtklive.com/en/news-single.php?ID=18171>

42 Deklaratë e përbashkët ‘Deklarata e Ambasadave/Zyrave të BE-së, Zyrës së PSBE-së/ BE-së dhe Ambasadës Amerikane në Kosovë mbi miratimin e ndryshimit kushtetues dhe ligjit përkrimin e Dhomave të Specializuara’, 3 gusht, 2015; <https://xk.usembassy.gov/joint-statement/>

43 Shih <https://www.scp-ks.org/en>

44 “Juridikcion i Gjykatës Speciale shtrihet në krimet e kryera nga dhe kundër individëve që kishin shtetësi të Kosovës/ Republikës Federative të Jugosllavisë gjatë periudhës nën hetim. Kufizimi i vetëm në juridikcionin e saj është përashtimi i çdo krimi të kryer nga individë përvaprëtëhet tashmë dëshmuar të kenë shtetësi të Kosovës/ Republikës Federative të Jugosllavisë kundër individëve përvaprëtëhet tashmë dëshmuar të kenë shtetësi të Kosovës/ Republikës Federative të Jugosllavisë” në: Korenica et al. (2016); f. 492.

45 Shih: Ligji nr. 05/L-053 mbi Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit Special; https://www.scp-ks.org/sites/default/files/public/05-l-053_a.pdf

46 Balkan Insight, ‘Schwendiman: Gjykata e re e luftës e Kosovës nuk është anti-shqiptare’, 15 nëntor, 2016; <https://balkaninsight.com/2016/11/15/schwendiman-new-kosovo-war-court-not-anti-albanian-11-14-2016/>

47 Korenica et al. (2016), f.490.

Në shkurt të vitit 2016, u nënshkrua marrëveshja me Holandën për të qenë nikoqire e GJSK-së⁴⁸. Ligji për themelimin e GJSK-së, parashikonte që selia e Dhomave të Specializuara do të ishte edhe në Kosovë dhe në një shtet nikoqir: Dhomat e Specializuara do ta kenë një seli në Kosovë. Siç parashikohet përmes një marrëveshje ndërkombëtare me Shtetin Nikoqir, Dhomat e Specializuara do të kenë edhe një seli në Shtetin Nikoqir jashtë Kosovës. Ishte parashikuar që zyra e ZPS-së ta ‘kishte një seli në Shtetin Nikoqir, por mund ta kishte edhe një seli në Kosovë’⁴⁹. Me ZPS-në që është një vazhdimësi e TFSH-së, me të njëjtin staf, me seli të konfirmuar në Hagë, dhe Sekretar të emëruar në prill të vitit 2016, GJSK-ja mund të krijohej. U desh kohë deri në mes të vitit 2017, që të gjithë mekanizmat dhe procedurat të ishin në funksion.

Për një kohë nuk dukej se kishte ndodhur shumë, të paktën jo publikisht. Shumë vëzhgues pyetën pse Prokurorit Specialist iu desh kaq shumë kohë për të ngritur aktakuza. Një ish gjykatës i EULEX-it theksoi se për gati tre vjet “autorëve të pretenduar të krimeve të tmerrshme u është lejuar të vazhdojnë jetën e tyre pa u ndëshkuar. Por ajo çka është më me rëndësi, dhe unë nuk mund ta theksoj këtë pikë sa duhet, viktimat dhe familjet e tyre janë detyruar të përdridhen në erën e pasigurisë për një kohë të gjatë, duke pritur që drejtësia të vendoset në vend.”⁵⁰ Përfundimisht, nga mesi i vitit 2018, filloj thirrja e parë - e njohur publikisht - e dëshmitarëve dhe të dyshuarve⁵¹. Ndërsa që u thirrën si të dyshuar ishte Ramush Haradinaj, në korrik të vitit 2019; një ish komandant i UÇK-së, lider i partisë Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe në kohën e thirrjes, Kryeministër i Kosovës. Haradinaj dha menjëherë dorëheqje pasi nuk dëshiron të paraqitej para GJSK-së si Kryeministër. Ai ishte ndjekur penalisht nga TPNJ-ja me akuza për krimet lufte dhe krimet kundër njerëzimit, por ishte liruar. Në mes të fundit të vitit 2018 dhe fundit të vitit 2019, mbi 100 ish luftëtarë të UÇK-së janë thirrur nga GJSK-ja⁵². Megjithëse, edhe vetë thirrjet, por edhe koha që është dashur për t'u shpallur aktakuzat, i bëri njerëzit e Kosovës të bëhen më të dyshimtë dhe mospërfillës ndaj GJSK-së⁵³.

Funksionet e Dhomave të Specilaizuara të Kosovës + Zyra e Prokurorit Special shkurtimisht

Dhomat e Specializuara (DHS): dhomat e specializuara nuk janë gjykatë e veçantë penale ndërkombëtare por një grup prej katër dhomave të specializuara brenda dhe të bashkangjitura në secilin nivel të sistemit gjyqësor të Kosovës: Dhoma e Gjykatës Themelore (‘gjykata e shkallës së parë’), Dhoma e Gjykatës së Apelit, Dhoma e Gjykatës Supreme dhe Dhoma e Gjykatës Kushtetuese. Të gjithë janë me seli në Hagë. DHS funksionojnë në përputhje me ligjet përkatëse të Kosovës,

48 Marrëveshja mund të gjendet këtu: <https://www.scp-ks.org/en/documents/host-state-agreement-between-netherlands-and-kosovo>

49 Neni 3.6 dhe 3.7, Ligji nr.05/L-053.

50 Pineles, D. “Gjykata fantazmë e vonon drejtësinë për viktimat e luftës në Kosovë”, BIRN, 21 mars, 2018; <https://balkaninsight.com/2018/03/21/ghost-court-delays-justice-for-kosovo-war-victims-03-19-2018/>

51 <https://kossev.info/former-member-of-the-kla-remzi-shala-arrested-after-months-on-the-run/>

52 Balkan Insight, ‘Prokurorët e thërrasin Kryeministrin e Kosovës për intervistë në Hagë’, 11 nëntor, 2019;

<https://balkaninsight.com/2019/11/11/prosecutors-call-kosovo-mp-for-interview-in-the-hague/>

53 Haxhiaj, Serbeze, ‘Kosova e hutuar nga pritja e gjatë për gjykimet e Gjykatës së Hagës’; Balkan Insight, 4 dhjetor, 2019; <https://balkaninsight.com/2019/12/04/kosovo-bemused-at-long-wait-for-hague-war-court-trials/>; dhe: Haxhiaj, Serbeze, ‘Në Kosovë, mosbesim ndaj Gjykatës së Hagës për krimet lufte’, 12 maj, 2020; Balkan Insight, <https://balkaninsight.com/2020/05/12/in-kosovo-distrust-of-hague-war-crimes-court-simmers/>

si dhe me të drejtën zakonore ndërkontaktare dhe të drejtën ndërkontaktare të të drejtave të njeriut (shih më poshtë). Dhomat e Specializuar kanë primat mbi të gjitha gjykatat e tjera në Kosovë⁵⁴. **Sekretari** është gjithashtu pjesë e DHS-së dhe përfshin njësi të ndryshme të mbështetjes administrative, si: mbështetje juridike, menaxhim gjykate, shërbime gjuhësore, informim dhe komunikim publik, burime njerëzore. Më tej, nën përgjegjësinë e Sekretarit bie: Zyra e Mbrojtjes dhe Mbështetjes së Dëshmitarëve, Zyra e Pjesëmarrjes së Victimave, Zyra e Mbrojtjes, Njësia e Menaxhimit të Paraburgimit dhe Ombudspersoni. Nuk ka autoritet të jashtëm (gjyqësor) që i mbikëqyr vendimet e marra nga GJSK-ja⁵⁵.

Zyra e Prokurorit Special (ZPS): kjo është zyra e zhvendosur e prokurorisë, e krijuar për të hetuar dhe, nëse justifikohet, për të ndjekur penalisht individë për krime të pretenduara në Raportin e Marty të janarit të vitit 2011. ZPS-ja është një vazhdimi i Task Forcës Speciale Hetuese (TFSH) dhe e ka trashëguar stafin dhe mandatin e saj. ZPS-ja është një zyrë e pavarur, e ndarë nga GJS-ja. ZPS-ja është gjithashtu pjesë e sistemit gjyqësor të Kosovës, por një institucion i përkohshëm me mandat dhe juridiksjon specifik «*mbi krime të caktuara kundër njerëzimit, krime lufte dhe krime tjera sipas ligjit të Kosovës që pretendohet të kenë ndodhur në mes të 1 janarit 1998 dhe 31 dhjetorit 2000*». Stafi i ZPS-së, si prokurorët, hetuesit dhe analistët, janë të gjithë shtetas të një vendi anëtar të BE-së ose të një prej pesë vendeve kontribues jashtë BE-së: Kanada, Norvegjia, Zvicra, Turqia dhe Shtetet e Bashkuara⁵⁶.

Lloji i krimeve që Prokurori Special mund t'i hetojë nën mandatin e tij, i përfshinë:

- ◆ Krimet kundër njerëzimit sipas Ligjit Ndërkontaktar (neni 13)
- ◆ Krimet e luftës sipas Ligjit Ndërkontaktar (neni 14); shkeljet e Konventave të Gjenevës dhe shkelje tjera serioze të ligjeve dhe zakoneve të zbat ueshme në konfliktet e armatosura ndërkontaktare, të njohura si të tillë në të drejtën zakonore ndërkontaktare.
- ◆ Krimet e tjera sipas Ligjit të Kosovës (neni 15); përfshirë krimet sipas Kodit Penal të Republikës Socialiste Federale të Jugosllavisë (1976); dhe Ligjit Penal të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës (1977); ose ndonjë ligji penal më të butë material në fuqi në mes të periudhës 1989 dhe korrik 1999/27 tetor 2000⁵⁷.

⁵⁴ Për detajet e sakta të ligjeve që e rregullojnë GJSK-në, shih: <https://www.scp-ks.org/en>, dhe për diskutime: Heinze, Alexander; Rregullorja e Procedurave dhe Dëshmive të Dhomave të Specializuar të Kosovës: Një diamant i punuar nën presion?; Zhurnal i Drejtësisë Penale Ndërkontaktare 15 (2017), 985-1009, ose: blogu i Michael Karnavas: Dhomat e Specializuar të Kosovës - Pjesa 1: Statuti i saj dhe rregulloret e procedurave dhe dëshmive me pak fjalë', <http://michaelgkarnavas.net/blog/2017/05/24/kosovo-specialist-chambers-part-1/>

⁵⁵ Korenica et al (2019), p. 485.

⁵⁶ Shih: <https://www.scp-ks.org/en/specialist-prosecutors-office/role-spo>

⁵⁷ Ligj nr. 05/L-053.

2.2 Komunikimi i GJSK-së me publikun

Një nga mësimet e TPNJ-së ishte se një gjykatë ndërkombejtare, e vendosur jashtë rajonit ku ishin kryer krimet nën hetim, përballet me sfida rreth mirëkuptimit dhe legjitimitetit lokal. Prandaj, kërkohet një komunikim i gjerë me shoqerinë e prekur⁵⁸. Dhomat e Specializuara e filluan programin e tyre të komunikimit në prill të vitit 2016, kur u emërua Sekretari, me konsultime me shoqerinë civile për t'i marrë pikëpamjet e tyre mbi nevojat e komunikimit⁵⁹. Përderisa që nga fillimi ishte realizuar kontakti i rregullt me përfaqësuesit e shoqërisë civile kosovare dhe serbe, kjo nuk ishte e mjaftueshme për të depërtuar te bashkësitë e ndryshme vendore në Kosovë ose Serbi. Shoqëria civile lobi për një investim shumë më të fortë në aktivitete të komunikimit për ta trajtuar keqinformimin dhe narrativat kundërshtare nacionaliste, gjersa punonte për të krijuar pranim të gjerë shoqëror të proceseve dhe rezultateve të GJSK-së⁶⁰. Zviceranët iu përgjigjën kësaj duke siguruar një grant me të cilin niveli i aktiviteteve të komunikimit të GJSK-së u rrit gjatë periudhës 2018-2019. Një Rrjet i Informatave Gjyqësore (RRIG) prej 15 OJQ-ve nga Kosova dhe Serbia, u krijuua në qershor të vitit 2018, për ta lehtësuar komunikimin e dyanshëm për reagime të rregullta mbi aktivitetet në terren, për të diskutuar se si të angazhohen më mirë me grupet e synuara dhe për ta mbështetur shpërndarjen e mesazheve kryesore⁶¹. Gjersa një shkëmbim i tillë ka ndodhur rregullisht dhe janë hartuar strategjite, zbatimi aktual është parë nga shumë përfaqësues të shoqërisë civile si shumë i vonë, shumë i ngadaltë dhe jo i mjaftueshëm: ai nuk e ka ndërtuar vizibilitetin dhe lidhjen e tij me viktimat dhe dëshmitarët ose popullsinë e gjerë⁶². Një prani e përhershme në Kosovë (ndoshta edhe në Serbi) e ekipit të komunikimit të Dhomave të Specializuara dhe njësisë së pjesëmarrjes së viktimave mund ta forcojë atë.

Krahas sesioneve të informacionit dhe shkëmbimit me organizatat e shoqërisë civile, ekipi i informimit i GJSK-së i vizitoi disa rajone për t'u takuar me komunitete të ndryshme. GJSK-ja raporton se i ka realizuar 75 takime me komunitete që nga viti 2018 deri në shkurt 2021, duke arritur mbi 1,700 pjesëmarrës direkt, duke përfshirë kështu edhe tryesa të rrumbullakëta, informime për media dhe trajnime me gazetarë nga rajoni. Gjatë periudhës me COVID-19, «të paktën dy ngjarje online për komunikimin me publikun, me audiencë në Kosovë» u mbajtën në muaj.⁶³ Idetë dhe planet përfushata të ngritjes së vetëdijes për të depërtuar në popullatën më të gjerë serbe dhe kosovare, u zhvilluan në vitin 2018, por u transmetuan përmes mediave në gjuhën shqipe dhe serbe, nga marsi i vitit 2020. Pesë video informative janë shfaqur «qindra herë në televizion [dhe]... janë shkarkuar mijëra herë nga faqja [e GJSK-së] në internet».⁶⁴

Disa vëzhgues argumentojnë se në krahasim me programet e informimit të gjykatave tjera ndërkombejtare, GJSK-ja ka ecur relativisht mirë⁶⁵. Sidoqoftë, pyetja nuk është se si gjykohet komunikimi i GJSK-së nga komuniteti i së drejtës ndërkombejtare; defintivisht, suksesi i komunikimit të GJSK-së do të përcaktohet

58 Smith, Allison, 'Komunikimi dhe Dhomat e Specializuara të Kosovës: Perspektiva e një praktikuesi të shoqërisë civile', *Rishikimi i së Drejtës Penale Ndërkombejtare* 20 (2020); 125-153.

59 Për më shumë detaje shih; <https://www.scp-ks.org/en/outreach>

60 Shih rekandimet në Visoka (2017) dhe Warren et al (2017).

61 OJQ-të pjesëmarrëse: Fondi për të Drejtën Humanitare (FDH) Kosovë; FDH Serbi; Qendra Evropiane për Çështje të Pakicave (ECMI) Kosovë; Nisma e të Rinjëve për të Drejtat e Njeriut (YIHR) Kosovë; YIHR Serbi, Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK); YUCOM; AKTIV; Qendra e Avokimit për Kulturë Demokratike (ACDC); Qendra për Hulumtim, Dokumentim dhe Publikim (CRDP); Integra; Qendra për Paqe dhe Tolerancë (CPT); ForumZFD Serbi; ForumZFD Kosovë, Romët në Veprim, Komiteti për të Drejtat e Njeriut në Serbi (CHRIS).

62 Biseda personale të autorit me përfaqësues të shoqërisë civile në Kosovë, mars, 2020.

63 Të dhënat e siguruara nga ekipi i komunikimit me publikun i GJSK-së, mars 2021.

64 Po aty.

65 Smith (2020).

nga komunitetet e prekura në Kosovë, Serbi dhe në diasporë. Në të njëjtën kohë, ekziston një kufi për atë që GJSK mund të bëjë, siç thekson Hehir (2019); «*Në praktikë, ndikimi i strategjisë së saj të marrëdhënieve publike me publikun e gjerë varet shumë nga shkalla në të cilën qeveria e Kosovës e mbështetë vetë gjykatën dhe strategjinë e saj të marrëdhënieve me publikun.*»⁶⁶ Një mbështetje e tillë qeveritare definitivisht ka munguar «*për faktin se shumë persona brenda qeverisë aktuale kanë lidhje intime me UÇK-në.*»⁶⁷ Për më tepër, konteksti i përgjithshëm politik dhe shoqëror në Kosovë e luan një rol të madh në formësimin e ndikimit më të gjerë të punës së GJSK-së në përgjithësi, dhe aktivitetave të saj në terren në veçanti. Dominimi i narrativave kundërshtuese dhe prania relativisht e vogël e GJSK-së në mediat e Kosovës dhe në terren kontribuojnë në legjitimitetin e kontestuar të GJSK-së në Kosovë.

2.3 Faza e re: aktakuzat publike të GJSK-së

Më 24 prill 2020, ZPS-ja njoftoi se i kishte dorëzuar aktakuzat e saj të para Gjyqtarit të Procedurës paraprake, pa i përmendur emrat e të dyshuarve. Procesi ku gjyqtari i procedurës paraprake ose do t'i konfirmojë ose t'i hedhë (pjessërisht) poshtë aktakuzat do të zgjaste në maksimum gjashtë muaj, deri më së largu, më 24 tetor 2020. Por nga fundi i qershorit 2020, ZPS-ja e lëshoi një deklaratë të jashtëzakonshme për shtyp, duke njoftuar se aktakuzat e ngritura pretendon se Presidenti i atëhershëm Hashim Thaçi, lideri i PDK-së Kadri Veseli dhe të dyshuarit tjetër të akuzuar janë penalish përgjegjës për rreth 100 vrasje. Kjo erdhi një ditë para se Presidenti Thaçi do të duhej të merrte pjesë në një takim në Uashington me homologun e tij serb, Vuçiq. Njoftimi ishte mjaft i veçantë pasi gjyqtari i procedurës paraprake ende nuk kishte vendosur për aktakuzën. Shpjegimi i Prokurorit Special ishte se ai «*e kishte konsideruar të nevojshme lëshimin e këtij njoftimi publik për akuzat, për shkak të përpjekjeve të përsëritura të Hashim Thaçit dhe Kadri Veselit për ta penguar dhe dëmtuar punën e GJSK-së. Besohet se Z. Thaçi dhe Z. Veseli e kanë bërë një fushatë të fshehtë për ta përbysur ligjin që e ka krijuar Gjykatën dhe për ta penguar punën e Gjykatës në mënyra të ndryshme, në përpjekje për të siguruar që ata të mos përballen me drejtësinë. Duke i ndërmarrë këto veprime, Z. Thaçi dhe Z. Veseli i kanë vënë interesat e tyre personale para viktimate të krimeve të tyre, sundimit të ligjit dhe gjithë popullit të Kosovës.*»⁶⁸ Nuk u dha asnjë arsyé për kohën e njoftimit, as nuk u dhanë detaje të mëtejshme mbi «fushatën sekrete». Kjo mund të ketë qenë në lidhje me propozimin që Presidenti Thaçi e bëri publik në gusht të vitit 2020, për ta ndryshuar kushtetutën e Kosovës dhe për t'i dhënë ligjvënësve në Kosovë një rol më të madh në përcaktimin e kornizës kohore për mandatin e GJSK-së.⁶⁹ Njoftimi i ZPS-së bëri që Presidenti Thaçi ta anulonte vizitën e tij në Uashington dhe ai njoftoi se do të jepte dorëheqje si President, apo të konfirmohej aktakuza.⁷⁰ Dy javë më vonë, Thaçi u thirr në Hagë për t'u marrë në pyetje.⁷¹

Pritja për vendimet përfundimtare mbi aktakuzat nga Gjyqtari i Procedurës paraprake doli të jetë një qetësi para stuhisë. Më 7 shtator, Shoqata e Veteranëve të UÇK-së pretendoi se kishte pranuar dosje origjinale nga GJSK-ja që i përmbanin emrat e dëshmitarëve të mbrojtur. Ata pretenduan se i kishin pranuar mbi 4,000

66 Hehir, Aidan, "Mësimet e nxëna? Mungesa e legjitimitetit lokal të Dhomave të Specializuara të Kosovës dhe implikimet e saj", *Rishikimi i të Drejtave të Njeriut*, 20 (2019): 267-287, p. 279.

67 Po aty.

68 Komunikatë për shtyp e ZPS-së, 24 qershor, 2020; <https://www.scp-ks.org/en/press-statement>

69 Shstoja 1 e Letër referimit të ndryshimit të propozuar të Kushtetutës së Kosovës; https://repository.scp-ks.org/details.php?doc_id=091ec6e98034d5bd&doc_type=stl_filing_annex&lang=eng

70 Prishtina Insight, 'Thaçi: 'Nëse konfirmohet aktakuza, unë menjëherë do të jap dorëheqje'; 29 qershor, 2020, <https://prishtinainsight.com/thaci-if-the-indictment-is-confirmed-i-will-immediately-resign/>

71 Prishtina Insight, 'Thaçi do të intervistohet në Hagë më 13 korrik'; 8 korrik, 2020; <https://prishtinainsight.com/thaci-to-be-interviewed-in-the-hague-on-july-13/>

dosje deri më 23 shtator. Shoqata e Veteranëve të UÇK-së pretendoi se nuk e dinte kush i kishte dorëzuar dosjet në zyrën e tyre. Sidoqoftë, ata i bënë publike disa pjesë të dosjeve dhe ndanë shumë dokumente me mediat, të cilat përbaheshin nga përdorimi publik i informacionit. Është e paqartë nëse shoqata e kishte organizuar vetë dorëzimin, ose se një palë tjeter i kishte vjedhur ato dhe ua kishte zbuluar atyre dosjet qëllimisht. GJSK-ja menjëherë dërgoi hetues në Shoqatën e Veteranëve të UÇK-së por nuk komentoi drejtpërdrejt për masat e mëtejshme.⁷² Thuhet se, shumica e dokumenteve që Shoqata e Veteranëve i kishin pranuar përfshinin korrespondencia në mes të TFSH-së dhe zyrës së prokurorit të Serbisë për krime lufte, që datojnë që nga viti 2014, që përbajnjë emra dhe vendndodhje të shumë dëshmitarëve nga Kosova, Serbia dhe Shqipëria.⁷³ ZPS-ja e lëshoi një deklaratë për shtyp më 22 shtator, në të cilën Prokurori Special deklroi se Shoqata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së «në një numër rasteshështë përfshirë në aktivitetë të cilat unë besoj se kanë për qëllim minimin e administrimit të duhur të drejtësisë» dhe që ZPS-ja «fuqishëm do të hetojë dhe ndjekë penalist individë të cilët do ta shpalosin identitetin e dëshmitarëve të mundshëm.»⁷⁴ Tri ditë më vonë, Kryetari dhe Nënkyetari i Shoqatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së u arrestuan për «vepra penale kundër administrimit të drejtësisë, përkatesisht për pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, frikësim të dëshmitarëve, hakmarrje dhe shkelje të fshehtësisë së procedurave». Përderisa mediat u përbajtën nga publikimi i përbajtjes së dosjeve që i kishin pranuar nga Shoqata e Veteranëve, rrjedhja e dosjeve nënkuçtonte një goditje serioze në punën e GJSK-së dhe ndikoi në besimin te viktimat dhe dëshmitarët.⁷⁵ Duhet të përcaktohet se çfarë ka ndodhur saktësish dhe si këto dokumente konfidenciale mund të ishin marrë ose si kanë rrjedhur nga GJSK-ja ose entitetet shoqëruese.

Menjëherë pas këtij incidenti të rëndë, Prokurori Speciali njoftoi për akuzën e parë të konfirmuar kundër Salih Mustafës, një ish-komandant i UÇK-së, më 28 shtator 2020. Në fund të tectorit, u konfirmua aktakuza kundër Presidentit Thaçi, e cila u bë publike më 5 nëntor. Dy rastet e konfirmuara përfshijnë përgjegjësi penale individuale për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit të kryera në vitin 1998 dhe vitin 1999, me një theks të veçantë në krimet kundër personave të dyshuar si kundërshtarë të UÇK-së. Thaçi dha dorëheqje në ditën e njoftimit, «për ta mbrojtur integritetin e shtetit», dhe u soll në Hagë.⁷⁶ Duke mos pasur mundësi tjetra, edhe Thaçi dhe ish-Kryetari i Parlamentit, Kadri Veseli, deklaruan se po udhëtonin vullnetarisht në Hagë për t'u «përballur me akusa të padrejta» dhe «për ta mbrojtur luftën e pastër, të bërë nga UÇK-ja». Dorëheqja e Thaçit, arrestimet dhe transferimet ndodhën me qetësi, ashtu si edhe ato të dy të tjerëve, të arrestuar nën të njëjtën akuzë.

Për më shumë detaje mbi aktakuzat, shihni kutinë në faqet 22/23.

72 Haxhiaj, S, 'Prokurorët e Hagës i marrin dosjet e rasteve të krimeve të luftës nga veteranët e Kosovës', Balkan Insight, 8 shtator, 2020; <https://balkaninsight.com/2020/09/08/hague-prosecutors-seize-war-crime-case-files-from-kosovo-veterans/>

73 Hajdari, Una, 'Mirësevini në fushëbetëjën gjyqësore të Kosovës', JUSTICEINFO.NET, 27 tetor, 2020, <https://www.justiceinfo.net/en/tribunals/mixed-tribunals/45786>Welcome-to-kosovo-judicial-battleground.html>

74 Komunikatë për shtyp e ZPS-së, 22 shator, 2020; <https://www.scp-ks.org/en/press-statement-0>

75 Haxhiaj, S, 'Rrijedhja e dokumenteve të gjykatës së Hagës i frikëson dëshmitarët e krimeve të luftës në Kosovë', Balkan Insight, 7 tetor, 2020, <https://balkaninsight.com/2020/10/07/hague-court-document-leak-scares-kosovo-war-crimes-witnesses/>

76 BBC News, 'Lideri i Kosovës Thaçi në paraburgimin në Hagë për akusa për krime të luftës', 5 nëntor, 2020; <https://www.bbc.com/news/world-europe-54822789>

Aktakzuat e konfirmuara të GJSK-së⁷⁷

Në mes të 28 shtatorit dhe 14 dhjetorit 2020 u shpallën tri aktakuzat e para: dy kishin të bënин me periudhën e Luftës në Kosovë dhe pasojat e saj direkte, kurse e treta kishte të bëjë me pengimin e punës së GJSK-së.

(1) Salih Mustafa:

Gjatë periudhës së mbuluar nga aktakuza (1 prill 1999 - fund i prillit 1999), Salih Mustafa ishte Komandant i një njësie guerile të BIA-së, e cila operonte brenda Zonës Operative të Llapit të UÇK-së. Aktakuza e akuzon Mustafën në bazë të përgjegjësisë penale individuale dhe përgjegjësisë superiore penale për krimet të kryera nga anëtarë të caktuar UÇK-së kundër personave të ndaluar në kompleksin e paraburgimit në Zllash. Aktakuza kundër Mustafës u konfirmua më 12 qershor, 2020 dhe versioni përfundimtar u bë publik më 28 shtator, 2020. Akuzat janë si në vijim: Katër akuza për krimet lufte: ndalim arbitrar, trajtim mizor, torturë dhe vrasje.

Mustafa u deklarua i pafajshëm për të gjitha pikat e aktakuzës.

(2) Thaçi, Veseli, Selimi dhe Krasniqi:

Funksionet e të akuzuarve gjatë periudhës së mbuluar nga aktakuza [mars 1998 - shtator 1999]:

Hashim Thaçi: Shef i Drejtorisë Politike dhe Informativë të UÇK-së. Në fund të marsit të vitit 1999, Thaçi ishte Kryeministër i Qeverisë së Përkohshme të Kosovës (QPK) dhe Komandant i Përgjithshëm i UÇK-së. Në momentin e aktakuzës, Thaçi shërbente si President i Kosovës, por dha dorëheqje pak para arrestimit.

Kadri Veseli: anëtar i Drejtorisë Politike të UÇK-së dhe Shef i shërbimeve të inteligjencës së UÇK-së. Në fund të marsit të vitit 1999, ai u bë shefi i Shërbimit Informativ të Kosovës dhe Ministër i Shërbimit të Inteligjencës të QPK-së. Në momentin e aktakuzës, Veseli shërbente si lider i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK).

Rexhep Selimi: Shef i Drejtorisë Operative të UÇK-së. Të paktën deri në gusht të vitit 1998, ai ishte Inspektor i Përgjithshëm i UÇK-së dhe në fund të marsit të vitit 1999, ai u bë Ministër i Rendit Publik / Ministër i Punëve të Brendshme të QPK-së. Në momentin e ngritjes së aktakuzës, Selimi ishte deputet i Vetëvendosjes në parlament.

Jakup Krasniqi: anëtar i Drejtorisë Politike të UÇK-së dhe zëdhënës zyrtar i UÇK-së. Më vonë gjatë vitit 1998, ai u emërua zyrtarisht si Zëvendës Komandant i UÇK-së. Me themelimin e QPK-së, Krasniqi u bë zëdhënësi i QPK-së.

77 Të gjitha infomatat janë nxjerrur nga <https://www.scp-ks.org/en/cases> ku edhe mund të gjenden më shumë hollësi.

Aktakuza kundër katër të akuzuarve u konfirmua më 26 tetor 2020 dhe u bë publike më 5 nëntor 2020. Në aktakuzë thuhet se krimet ishin kryer të paktën nga marsi, 1998 deri në shtator, 1999 dhe u zhvilluan në pesëmbëdhjetë vende në të gjithë Kosovën, si dhe në Kukës dhe Cahan, në Shqipërinë e Veriut. Ato dyshohet se janë kryer nga anëtarët e UÇK-së kundër qindra civilëve dhe personave që nuk merrnin pjesë në luftime. Aktakuza pretendon se Thaçi, Veseli, Selimi dhe Krasniqi janë individualisht përgjegjës penalisht, në përputhje me format e ndryshme të përgjegjësisë penale për krimet, të cilat ishin kryer në kontekstin e një konflikti të armatosur jo-ndërkombëtar në Kosovë dhe ishin pjesë e një sulmi të përhapur dhe sistematik kundër personave të dyshuar se ishin kundër UÇK-së. Kundërshtarë të tillë dyshohet se përfshinin persona që ishin ose u përceptuan të kenë: (a) bashkëpunuar ose të janë lidhur me forca ose zyrtarë të RFJ-së ose institucioneve shtetërore; ose (b) në një mënyrë të ndryshme nuk i kanë mbështetur qëllimet ose mjetet e UÇK-së dhe më vonë të QPK-së, përfshirë personat e lidhur me Lidhjen Demokratike të Kosovës (LDK) dhe personat serbë, romë dhe të etnive tjera.

Akuzat janë si më poshtë:

- ◆ Gjashtë akuza për krime kundër njerëzimit: përndjekje, burgim, akte të tjera çnjerëzore, torturë, vrasje, zhdukje me forcë e personave.
- ◆ Katër akuza për krime lufte: arrestim dhe ndalim i paligjshëm ose arbitrar, trajtim mizor, torturë, vrasje.

Paraqitjet fillestare u zhvilluan në nëntor të vitit 2020 para Gjykatësit të Procedurës Paraprake dhe që të katër u deklaruan të pafajshëm për të gjitha pikat e aktakuzës.

(3) Hysni Gucati and Nasim Haradinaj:

Gjatë periudhës së mbuluar nga aktakuza, Hysni Gucati ishte Kryetar, dhe Nasim Haradinaj, Zëvendës Kryetar, i Shoqatës së Veteranëve të Luftës së Ushtorisë Çlirimtare të Kosovës. Aktakuza kundër tyre u konfirmua më 11 dhjetor, 2020 dhe u bë publike më 14 dhjetor, 2020. Në aktakuzë thuhet se në mes të paktën 7 dhe 25 shtator, 2020, me rastin e tre konferencave për shtyp dhe ngjarjeve të tjera të transmetuara, si dhe përmes shpërndarjes së mëtejshme, përfshirë deklarata në mediat sociale, Gucati dhe Haradinaj e shpalosën, pa autorizim, informacionin e mbrojtur sipas ligjit të Dhomave të Specializuara, përfshirë detajet identifikuuese të dëshmitarëve të caktuar (të mundshëm). Gucati dhe Haradinaj gjithashtu bënë akuza dhe vërejtje nënçmuese kundër dëshmitarëve (të mundshëm) dhe shprehën vazhdimisht qëllimin e tyre për t'i minuar Dhomat e Specializuara.

Akuzat janë si në vijim:

- ◆ Dy akuza për vepra penale kundër rendit publik: Pengesa e personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare (dy akuza);
- ◆ Katër akuza për vepra penale kundër administrimit të drejtësisë dhe administratës publike: frikësim gjatë procedurave penale, hakmarrje, shkelje e fshehtësisë së procedurave (dy akuza).

2.4 Kritikat ndaj GJSK-së

Hulumtimi i Këshillit të Evropës dhe hetimi pasues penal nga TFSH-ja siguruan baza të mjaftueshme për procedurat ligjore kundër autorëve të pretenduar të krimeve, ish-anëtarëve të UÇK-së. Në vitin 2020, kjo u konfirmua përfundimisht nga aktakuzat publike. Nuk është përvju habitur se në Kosovë GJSK-ja është një gjykatë kontradiktore dhe ndjenja mbizotëruese është që GJSK-ja u krijua përvjetor t'i ndjekur penalisht vetëm shqiptarët (e Kosovës), është e njëjanshme dhe si e tillë ka pasur pak mbështetje shoqërore.⁷⁸ Elita politike e Kosovës, shumë prej të cilëve ishin dikur anëtarë të UÇK-së, e refuzoi masivisht reportin nga Dick Marty dhe hetimin pasues të TFSH-së.⁷⁹ Më vonë, ka pasur disa përpjekje përvjetor t'i parandaluar krijimin e GJSK-së, përvjetor t'i parandaluar hetimet e saj dhe përpjekje përvjetor t'i parandaluar funksionimin e GJSK-së. Anëtarët e parlamentit u përpokoën ta revokon ose ndryshon ligjin që e lejoi krijimin e Dhomave të Specializuar, në fund të vitit 2017 dhe në fillim të vitit 2018. Çdo herë, aleatët perëndimorë të Kosovës paralajmëruan se kjo do t'i rezikonte marrëdhëni me ta dhe mbështetjen e tyre.⁸⁰ Përpjekja e fundit, në gusht të vitit 2020, ishte një propozim nga Presidenti i atëhershëm Thaçi përvjetor t'i parandaluar kushtetutën e Kosovës dhe përvjetor t'i dhënë ligjvënësve në Kosovë një rol më të madh në përcaktimin e kornizës kohore përvjetor mandatin e GJSK-së.⁸¹ Ky propozim u hodh poshtë nga Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese, e cila është nën GJSK-në.

Disa shoqata të veteranëve të luftës së UÇK-së e përbëjnë një grup tjetër shumë të zëshëm, që i kundërvihet me forcë GJSK-së. Motivimi i tyre është i njëjtë me atë të politikanëve; ata e shohin luftën e tyre kundër Serbisë si legitime dhe mënyrën e vetme përmes së cilës Kosova mund të ishte bërë e pavarur. Një pjesë e madhe e qytetarisë shqiptare të Kosovës mendon njësoj. Narrativa mbizotëruese është se forcat serbe ishin agresorët dhe autorët e krimeve masive, ndërsa UÇK-ja ishin luftëtarë të lirisë dhe përvjetorët e tyre janë ekskluzivisht shqiptarët e Kosovës.⁸² Në përgjithësi, vështirë se përmenden krimet që mund të janë kryer nga ana e UÇK-së. Në vitin 2020, Kryeministri i atëhershëm Kurti pushoi një nga këshilltarët e tij përkomentin se luftëtarët individualë të UÇK-së kanë kryer krimet gjatë luftës në periudhën e viteve 1998-99, gjë që shkaktoi reagime të furishme te shqiptarët e Kosovës.⁸³

Në mesin e të thirurve nga GJSK-ja ishin disa ish-anëtarë të shquar të UÇK-së dhe shumë prej tyre e kanë komentuar këtë përmes mediave sociale ose intervistave. Deklaratat e tyre në përgjithësi i referohen drejtësisë së kauzës së tyre, gabimit përvjetor të themelin e GJSK-së dhe se ata do t'i «*dalin fitimtarë*», duke e portretizuar veten si martirë kombëtarë.⁸⁴ Në vitin 2017, Shoqata e Veteranëve të UÇK-së e lëshoi një peticion përvjetor t'i parandaluar Ligjin mbi Dhomat e Specializuar të Kosovës sepse ata e shohin atë si diskriminues ndaj shqiptarëve dhe «*mono-etnik*» dhe argumentojnë se duhet

78 Visoka (2017)

79 Për shembull: Ochsenbein, Gaby, Raporti e sfidon "mitin themelues" të Kosovës, Swissinfo, 24 janar, 2011; <https://www.swissinfo.ch/eng/report-challenges-kosovo-founding-myth-/29317316>

80 Balkan Insight, 'Perëndimi e paralajmëron Kosovën kundër minimit të Gjykatës së Luftës', 5 janar, 2018; <https://balkaninsight.com/2018/01/05/west-warns-kosovo-against-undermining-war-court-01-05-2018/>

81 'Shtoja 1 e Letër referimit të ndryshimit të propozuar të Kushtetutës së Kosovës'; https://repository.scp-ks.org/details.php?doc_id=091ec6e98034d5bd&doc_type=sil_filing_annex&lang=eng

82 Visoka (2017).

83 Balkan Insight, 'Në Kosovë vlon mosbesimi ndaj gjykatës së krimeve të luftës në Hagë', 12 maj, 2020; <https://balkaninsight.com/2020/05/12/in-kosovo-distrust-of-hague-war-crimes-court-simmers>

84 Për shembull: Balkan Insight, 'Prokurorët e Hagës thërrasin më shumë ish-luftëtarë të Kosovës', 13 nëntor, 2019 <https://balkaninsight.com/2019/11/13/hague-prosecutors-summon-more-kosovo-ex-guerrillas/>

ta përfshijë edhe ndjekjen penale të serbëve që kanë kryer krimet në Kosovë.⁸⁵ Për ta, pavarësisht mandatit të saktë të GJSK-së, po gjyket UÇK-ja dhe ata duhet ta mbrojnë veten dhe kauzën e tyre, përderisa autorët serbë të kimeve gjëojnë pandëshkueshmëri.⁸⁶ Në momente të ndryshme, veteranët e UÇK-së kanë organizuar protesta publike kundër GJSK-së.⁸⁷ Përderisa këto protesta nuk ishin masive, mesazhi i tyre se GJSK-ja është një gjykatë anti-UÇK, dominon në diskursin publik. Veprimi më i fundit kundër GJSK-së ishte ndarja e «*dosjeve gjyqësore të rrjedhura*» në shtator, 2020 nga (individë nga) Shoqata e Veteranëve të UÇK-së me mediat, gjë që qartë e pengon punën e GJSK-së duke i frikësuar dëshmitarët (potencialë) – për të cilën Kryetari dhe Zëvendëskryetari i shoqatës u arrestuan.

Ekziston një konsensus i gjerë midis shqiptarëve të Kosovës që krimet e kryera nga serbët gjatë luftës në Kosovë qëndrojnë kryesisht të pandëshkuara. Për më keq, po krijohet një përshtypje se krimet e kryera nga UÇK-ja barazohen me ato të kryera nga ushtria, forcat e inteligjencës dhe policia serbe në Kosovë me faktin se ekziston një gjykatë e specializuar për krimet lufte për Kosovën. Në një publikim së voni të Revistës Ndërkombëtare të Ligjit Penal mbi ligjin dhe politikën e GJSK-së, Holvoet (2020) argumenton se kjo ndjenjë e drejtësisë së njëanshme është e kuptueshme dhe «*deri në një shkallë të rëndësishme, e justifikuar*».⁸⁸ Kur Kadri Veseli dhe Hashim Thaci u arrestuan dhe u sollën në Hagë, filloj një fushatë e madhe në media, media sociale dhe përmes posterëve ku thuhej «Liria ka emër: UÇK», me emblemën e UÇK-së, duke rezonuar me një audiencë të gjerë të shqiptarëve. Përkundër këtij konteksti në të cilin ndjenjat mbi GJSK-në po dominohen nga elita e UÇK-së dhe lëvizjet më ekstreme, OShC-të me seli në Kosovë kanë pasur hapësirë dhe mundësi të kufizuar për të promovuar narrativa që bazohen në parimet e ballafaqimit më të kaluarën, duke përfshirë këtu edhe rëndësinë e hetimit të kimeve të luftës dhe kimeve kundër njerëzimit, kundër civilëve dhe kundërshtarëve politikë në Kosovë, dhe më gjerë, duke i dhënë prioritet angazhimit më gjithëpërfshirës me proceset e drejtësisë tranzicionale përtej masave ndëshkuese.

Krijimi i GJSK-së jo vetëm që ka marrë kritika brenda Kosovës, por është vënë në pyetje nga disa (ish) prokurorë, diplomatë dhe vëzhgues që merren me rajonin. Krahas kritikave mbi mandatin selektiv, këto përfshijnë kryesisht pyetje mbi bazën e provave të Raportit Marty, barazimin moral të kimeve të kryera nga UÇK-ja me ato të forcave jugosllave dhe serbe ose me dyshimin për ndikim politik mbi mandatin ose vendimet e saj të marra.⁸⁹ Janë ngritur pyetje edhe për rolin e luajtur nga vetë komuniteti ndërkombëtar

85 Balkan Insight, 'Fushata e veteranëve të Kosovës kundër Ligjit të Gjykatës Speciale', 12 dhjetor, 2017 <https://balkaninsight.com/2017/12/12/kla-veterans-with-petition-against-kosovo-specialist-chambers-law-12-12-2017/>

86 TPNI-ja ka ndjekur dhe dënuar serbë për krimet lufte në Kosovë vetëm në dy raste, dhe përgjegjësi kryesor, Slobodan Milosheviç vdiq nga një sulm në zemër në burg gjersa po gjykohej në Hagë në vitin 2006, gjë që ishte një zhgënjim i madh për viktimat e agresionit serb.

87 Balkan Insight, 'Veteranët e luftës në Kosovë protestojnë kundër akuzave ndaj Presidentit Thaci', 9 korrik, 2020; <https://balkaninsight.com/2020/07/09/kosovo-war-veterans-protest-charges-against-president-thaci/>

88 Holvoet, M., 'Prezantimi i Çështjes Speciale: Këndvështrime kritike mbi Ligjin dhe Politikën e Dhomave të Specializuara të Kosovës dhe Zyrës së Prokurorit Special', *Rishikimi i Ligjit Penal Ndërkombëtar 20* (2020), 1-15; f.4.

89 Për shembull; një ish-prokuror i TPNI-së në gjykimin e Slobodan Milosheviçit, Sir Geoffrey Nice, vuri në dyshim dëshmitë e hulumtimit të Marty në një artikull 'Kush është K144?', Rishikimi i Londrës i Librave, Vell. 33 Nr. 3, 3 shkurt, 2011; <https://www.lrb.co.uk/the-paper/v33/n03/geoffrey-nice/who-is-k144>; ish gjyqtari i EULEX-it argumenton që krijimi i gjykatës së re ishte një gabim pasi e vonon drejtësinë për viktimat; <https://balkaninsight.com/2018/03/21/ghost-court-delays-justice-for-kosovo-war-victims-03-19-2018/>; Daan Everts, ish-diplomati, ish-shefi i misjonit të OSBE-së në Shqipëri dhe Kosovë, argumenton në një artikull të qershrit të vitit 2020, që GJSK-ja duhet të bëjë më shumë përpjekje për ta shmangur ndikimin politik dhe paragjykimet; <https://www.nrc.nl/nieuws/2020/07/09/machinations-bij-kosovo-proces-bemoeilijken-de-positie-van-de-eu-a4005434>; Eliot Engel, Kryesues i Komitetit të Punëve të Jashtme të Dhomës së SHBA-së paralajmëron se GJSK-ja të bëhet një "gjykatë etnike" në Dëgjimet në Ballkan, 8 dhjetor, 2020; <https://foreignaffairs.house.gov/2020/12/engel-remarks-at-hearing-on-the-balkans>; Ish-kreu i Hetimeve të OSBE-së, William Walker, dhjetor, 2020; <https://exit.al/en/2020/12/21/us-diplomat-says-serbia-should-face-justice-for-war-crimes-in-kosovo/>

(NATO), duke lejuar të ndodhin krimet të rënda nën vëzhgimin e tyre ose duke mos qenë të gatshëm t'i ndjekin penalisht këto krimet në mënyrë efektive (UNMIK, EULEX).⁹⁰

Edhe akademikët kanë shprehur shqetësimë ose kritika që nga themelimi i GJSK-së. Për shembull, Muharremi (2019) argumenton që GJSK-ja u krijuar si një gjykatë nationale, megjithëse e kontrolluar ndërkombëtarisht, jo vetëm për t'i ndjekur penalisht autorët e krimave të luftës, por edhe për ta mbrojtur SHBA-në dhe disa shtete anëtare të BE-së të përfshira përmes NATO-s në Kosovë, nga ekspozimi i mundshëm ligjor në lidhje me përfshirjen e tyre në Kosovë gjatë kohës kur janë kryer krimet e pretenduara.⁹¹ Karnavas (2020) thelohet pak më thellë duke argumentuar se GJSK-ja «*dukut se është kriuar për shkak të mungesës së vullnetit politik të EULEX-it për të vepruar në Kosovë. EULEX-i kishte kapacitet (donatorët e tij kishin xhepa mjaft të thellë) por ka shumë të ngjarë që nuk e kishte prirjen (duke i pasur parasysh shoqatat politike ose pozicionet e atyre që dyshohen) për t'i hetuar dhe ndjekur penalisht individët e lidhur me UÇK-në dhe /ose politikanët me ndikim.*⁹² Vetëm përmes zbulimeve nga Del Ponte dhe dëshmive të mbledhura në hetimet pasuese, EULEX-i «*mund të ishte detyruar të vepronte*». Dick Marty tashmë kishte komentuar në raportin e tij se misionet ndërkombëtare në Kosovë e kishin prioritet stabilitetin mbi llogaridhëni. Karnavas sugjeron që dështimi për ta trajtuar hendekun e pandëshkueshmërisë pas konfliktit ndoshta «*ishte rezultat i një ngurrimi nga ana e komunitetit ndërkombëtar për tu marrë me çështje të drejtësisë tranzicionale që ishte një rezik për minimin e stabilitetit politik të brishtë të Kosovës, të ndërthetur me shqetësimë tjera të jashtme të sigurisë së shteteve dhe aktorëve ndërkombëtarë (si SHBA-ja, BE-ja dhe NATO-ja) në garë kundër shteteve tjera (si Rusia) për interesat e tyre të bashkërenduara politike, ekonomike ose strategjike në Evropën Juglindore (Ballkan).*⁹³

Që nga fillimi, GJSK-ja ka vuajtur nga mungesa e legjitimitetit lokal. Kërkesa për një gjykatë speciale për krimet lufte, modelimi dhe organizimi i saj erdhi nga 'ndërkombëtarët'. Në procesin e krijimit të GJSK-së, projektuesit e saj duket se kanë qenë më të interesuar për ta siguruar legjitimitetin e saj ndërkombëtar ligjor sesa legjitimitetin e saj lokal. Zgjedhja e selisë së saj jashtë Kosovës dhe stafi ndërkombëtar e forcon funksionimin e saj të pavarur por e dëshmon si sfiduese legjitimitetin dhe mirëkuptimin shoqëror mbi GJSK-në.⁹⁴ Hulumtimi ynë i perceptimit në vitin 2017 tregoi se vetëm rrëth 5% e popullsisë së Kosovës e konsideronin veten shumë të informuar rrëth GJSK-së, ndërsa mbi 30% e konsideronin veten të mos ishin të informuar fare, dhe vështirë se dikush kuptonte mandatin e saktë të gjykatës. Hulumtimi nga Hehir në vitin 2018 shpalosi se legjitimeti lokal i GJSK-së mbeti i ulët dhe operimet e saj po përfjetohen si diçka që ndodh larg. Hehir vëren se ekzistonte ende dyshimi i përrhapur në lidhje me qëllimin e GJSK-së dhe shumë njerëz e konsideronin atë të kriuar nga aktorë ndërkombëtarë «*gjoja të imponuar nga interesa të veçanta nationale dhe motive politike*»⁹⁵. Siç vëren Holvoet (2020), është «*kombinimi i njëanshmërisë së juridikacionit të ZPS-së dhe GJS[K]-së me ndjenjën e zhgënjimit midis shqiptarëve të Kosovës, në lidhje me mosndëshkimin e serbëve dhe mohimin serb*» i cili krijon një kontekst shumë të ndjeshëm dhe sfidues që GJSK-ja të veprojë në të.⁹⁶

90 Shih: Artikull në OBC Transeuropa nga Andrea Lorenzo Capussela, 'Raporti i TFSH-së flet më pak për Kosovën sesa për bashkësinë ndërkombëtare', 31 korrik, 2014; <https://www.balcanicaucaso.org/eng/Areas/Kosovo/The-SITF-report-speaks-less-of-Kosovo-than-of-the-international-community-154772>

91 Muharremi (2019, p. 304): "Intervenimi ushtarak i NATO-s kundër Jugosllavisë në vitin 1999 është tashmë objekt i një hetimi të brendshëm nga TPNJ-ja. [...] Krijimi i Gjykatës Speciale si gjykatë nationale i mbron zyrtarët e huaj nga hetimi për çdo lloj përfshirje në krimet e pretenduara."

92 Karnavas, M.G., 'Rregulloret e Procedurave dhe Dëshmive të Dhomave të Specializuara të Kosovës: Më shumë nga i njëjtë hibriditet me transparencë të shtuar të Prokurorisë', Rishikimi i së Drejtës Penale Ndërkombëtare 20 (2020); 77-124; f.80.

93 Karnavas (2020), f. 80.

94 Cross, Mathew E., 'Pajisja e Dhomave të Specializuara të Kosovës për t'i gjykuar krimet transnacionale: Vështrime mbi pavarsinë dhe bashkëpunimin', Zhurnal i Drejtësisë Penale Ndërkombëtare 14 (2016); 73-100.

95 Hehir (2019).

96 Holvoet (2020).

Kështu, që nga përfundimi i Luftës në Kosovë, disa institucione u angazhuan për gjykimin e kimeve të luftës që kishin ndodhur në territorin e Kosovës. Në këto njëzet vitet e fundit, rezultatet e atyre kanë qenë të kufizuara, dhe asnjë nga këto përpjekje nuk e ofroi një masë të kënaqshme të drejtësisë për viktimat dhe nuk arriti të bëjë shumë për të vërtetën ose shërimin shoqërор.⁹⁷ Nismat e tjera të drejtësisë tranzicionale në Kosovë kanë qenë ose shumë të vogla në fushëveprimin e tyre për të kontribuar në ndryshime më të gjera shoqërore, shumë të politizuara ose kanë dështuar të prodhojnë ndonjë rezultat të prekshëm. GJSK-ja u krijuar në një kontekst të zhgënjimit të gjerë në gjyqet e kimeve të luftës dhe u detyrua në Kosovë nga sponzorët e saj ndërkombëtarë me një mandat problematik. Përkundër këtij sfondi, ka qenë detyrë e madhe për GJSK-në që të arrijë mirëkuptimin dhe pranimin lokal për punën e saj. Në fund, GJSK-ja posaçërisht duhet të tregojë se është e aftë t'i përcaktojë faktet mbi krimet e kryera, që do të çojnë në dënim, duke vendosur një masë të shëndoshë të drejtësisë për viktimat. Vetëm atëherë, puna e saj mund të ndihmojë në hapjen e bisedimeve rreth përvojave të ndryshme të së kaluarës së dhunshme të Kosovës.⁹⁸

97 Visoka (2017).

98 Po aty.

3. Të gjeturat e Studimit të Përceptimit të Publikut mbi GJSK-në


Studimi i përceptimit publik u krye në mes të shtatorit 2020, pak para se GJSK-ja t'i lëshonte aktakuzat e saj të para.⁹⁹ Këto zhvillime të fundit mund të kenë pasur një ndikim në kuptimin dhe përceptimin e publikut mbi GJSK-në në Kosovë, të cilat nuk janë pasqyruar në të dhënrat e mëposhtme. Ky studim i shtatorit 2020 u administrua në 38 komuna të Kosovës dhe përfshiu gjithsej 1.065 shtetas të Kosovës mbi 18 vjeç: 815 Shqiptarë-K, 150 Serbë-K dhe 100 Të tjerë-K (pakica joserbe). Dy grupet e fundit janë mostra të mbi-mostruara për të lejuar një analizë më të besueshme në nivelin etnik. Mostra është ponderuar në përputhje me rr Ethanat, para se të bëhej analiza, në mënyrë që ta pasqyrojë strukturën etnike të Kosovës. Anketa mbi përceptimet ndaj Gjykatës Speciale të Kosovës është një version i rregulluar i vitit 2017; pyetësori mund të gjendet në Shtojcën 1. Të gjitha tabelat e të dhënave të përmendura më poshtë mund të gjenden në Shtojcën 2.

⁹⁹ GJSK-ja gjithashtu mbledhë të dhëna për njohuritë dhe qëndrimin e publikut ndaj GJSK-së në Kosovë dhe Serbi përmes studimeve vjetore të opinioneve. Ato u kryen në vitin 2017 (në Serbi) dhe 2018 (në Serbi dhe Kosovë) dhe u raportuan nga GJSK-ja në reportin e tyre të Programit të Komunikimit. Edhe në vitin 2019 u kryen studime të opinionit (në Serbi dhe Kosovë) megjithëse rezultatet ende nuk janë publikuar.

3.1 Njohuritë e publikut mbi GJSK-në mbeten në nivel të ulët

Fig. 3.1

Sa e konsideroni vetën të informuar rreth Gjykatës Speciale?




Deri në shtator të vitit 2020, më pak njerëz e konsideruan veten të informuar për GJSK-në sesa tre vjet më parë; me 34,4% që ndihen «disi» ose «shumë të informuar» kundrejt 52% në vitin 2017, me vetëm 2,9% të anketuarve që thonë se janë «shumë të informuar» (4,7% në vitin 2017). 64% e të anketuarve ndihen «deridiku të painformuar» ose «aspak të informuar» në vitin 2020, kundrejt 47,3% në vitin 2017. Ky është një nivel i konsiderueshmë i ulët i njohurive të përgjithshme të publikut gjatë një periudhe në të cilën komunikimi i GJSK-së është rritur. Shpjegimet e mundshme mund të jenë se qytetarët shqetësohen kryesisht për zhvillime të tjera, të tilla si kriza e vazhdueshme politike, paqëndrueshmëria ekonomike dhe mirëqenia sociale. Mund të ketë të bëjë edhe me faktin se komunikimi i GJSK-së mund të ketë qenë i kufizuar shumë në grupe specifike të cilat nuk kanë vepruar si 'shumëzues' të mesazheve të GJSK-së.

Kur shikohet sfondi etnik, shqiptarët janë deridiku më të informuar se grupet tjera, me 37,6% të shqiptarëve që tregojnë se nuk janë «aspak të informuar», ndërsa ky është rasti për 73,8% të serbëve të Kosovës dhe për 65,9% të pakicave tjera. Këto ndryshime ka të ngjarë të jenë rezultat i grupeve të ndryshme që përdorin burime të ndryshme gjuhësore për informim. Burrat janë më të informuar se gratë, me 43,7% të të anketuarve meshkuj që janë «deridiku» ose «shumë të informuar» kundrejt 25,7% të grave [tabela 1.1; Shtojca 2].

Nuk ka ndonjë ndryshim të jashtëzakonshëm në mes të grupmoshave sa i përket shkallës se sa e konsiderojnë veten të informuar; rreth një e treta nga të gjitha grupmoshat (31,8% në 37,3%) janë ose «deridiku» ose «shumë të informuar» [tabela 1.2].

Fig. 3.2

Sipas mendimit tuaj, cili është qëllimi i përgjithshëm i Gjykatës Speciale?



Kjo ishte një pyetje e hapur për t'i lejuar njerëzit ta ndajnë kuptimin e tyre për GJSK-në. Nga të gjithë të anketuarit, 39,5% nuk ishin të gatshëm t'i përgjigjen kësaj pyetjeje (si të tillë ato nuk janë përfshirë në Figurën 3.2). Nga ata që iu përgjigjën kësaj pyetjeje; 21,2% deklaruan se nuk e dinin qëllimin e GJSK-së (krahasuar me 12,5% në vitin 2017). 27,4% e të anketuarve mendojnë se qëllimi i saj është t'i ndjekë penalisht krimet e luftës të kryera në Kosovë - pavarësisht nga kush (krahasuar me 34,6% në vitin 2017). 5,2% aktualisht mendojnë që GJSK-ja do t'i ndjekë penalisht kriminelët shqiptarë dhe 3,7% mendojnë se do t'i ndjekë penalisht shqiptarët për kime lufte (shifrat për vitin 2017 ishin përkatësisht 0% dhe 0,6%). 8,3% e kuptojnë që GJSK-ja do ta ndjekë penalisht UÇK-në (organizatën) për kime të pretenduara (krahasuar me 9,6% në vitin 2017) dhe 5,7% mendojnë se ajo është për t'i ndjekur penalisht individët e UÇK-së (komandantë ose ushtarë), krahasuar me 12,7 % në vitin 2017. Diku 5,7% u përgjigjën se ata mendojnë se ajo është aty për ta dëmtuar imazhin e UÇK-së (krahasuar me 1,8% në vitin 2017). Përsëri, askush nuk e dinte që GJSK-ja do t'i ndjekë penalisht krimet e

përfshira në Raportin e Marty të vitit 2011 dhe hetimin pasues të TFSH-së. Këto të gjetura tregojnë se ka ende shumë pak kuptim midis qytetarëve për mandatin aktual të GJSK-së. Edhe me shtrirjen e komunikimit nga GJSK-ja, informacioni duket se nuk arrin te publiku i gjerë.


Kur shikohen të dhënët e ndara sipas përkatësisë etnike, është e jashtëzakonshme që të anketuarit serbë-K dhe të tjera-K u përgjigjën se ata, ose nuk e dinin qëllimin (përkatësish 10% dhe 50%) ose mendojnë se ajo është për ndjekjen penale të krimave të luftës të kryera në Kosovë, jo duke e lidhur atë me autorë të veçantë të krimave (përkatësish 90% dhe 33%). Kjo ka të ngjarë të konfirmojë konstatimin e vitit 2017 se ata nuk e kuptojnë që jo të gjitha krimet që lidhen me periudhën e luftës po ndiqen penalisht, por vetëm ato që pretendohen në raportet «Marty» dhe të TFSH-së.

Nga cilat burime keni marrë informacione mbi Gjykatën Speciale të Kosovës deri tash?

Të anketuarit mund të zgjedhnin përgjigje të shumëfishata nga një listë e burimeve të mundshme të informacionit mbi GJSK-në. Kjo tregon që TV stacionet (37,3%), mediat sociale (19,1%) dhe portalet e mediave në internet (17,4%) janë përdorur më shpesh në mes të viteve 2015-2020 për informacion mbi GJSK-në [tabela 2.1]. Deklaratat e politikanëve shqiptarë si burim informacioni u përmendën nga 12,4% e shqiptarëve, ndërsa krahasimisht më shumë të anketuar serbë (54,6%) përdorin deklaratat e politikanëve serbë si burime të informacionit [tabela 2.1]. Kur shikohet mosha, një e katërta (26,6%) e të rinjve (18-24 vjeç) i përmenden gazetat si burim informacioni, ndërsa për grupmoshat më të vjetra kjo është vetëm 2,7% -7,5%. Nuk është

Fig. 3.3

Gjykata Speciale ka një mandat dhe juridikson specifik mbi krimet kundër njerëzimit, krimet e luftës dhe krimë të tjera sipas ligjit të Kosovës, të cilat janë kryer në Kosovë ndërmjet 1 janar 1998 dhe 31 dhjetor 2000, nga ose kundër qytetarëve të Kosovës ose Republikës Federale të Jugosllavisë. Kush mendoni se janë njerëzit që me gjasë do t'i nënshtrohen ndjekjes penale nga Gjykata Speciale?




për t'u habitur që më shumë se gjysma e të rinjve të moshave 18-34 vjet, i përdorin mediat sociale si burim informacioni. Për grupmoshat më të vjetra, media sociale është gjithashtu një burim i rregullt informacioni, megjithëse zvogëlohet me moshën nga 35,1% në 10,7% [tabela 2.2].

Me këtë përshkrim zyrtar, shumica e të anketuarve (40,1%) menduan se GJSK-ja do t'i ndjekë penalisht «ata që kryen kime lufte në periudhën e viteve 1998-2000, përfshirë politikanë, pavarësisht nga përkatësia e tyre etnike» (përkundrejt 33,8% në vitin 2017). Duke shikuar në përkatësinë etnike, 41,1% e shqiptarëve-K, 58,3% e serbëve-K dhe 45,0% e të tjerëve-K menduan se kjo është kështu. Pak më shumë se një e katërtë (26,7%) e të gjithë të anketuarve menduan se do t'i ndjekë penalisht «Shqiptarët e Kosovës, përfshirë politikanët që kryen kime lufte në periudhën e viteve 1998-2000» (mjaft e ngjashme me 25% në vitin 2017), dhe 13,8% menduan se ajo u krijua për t'i ndjekur penalisht «Serbët e Kosovës, përfshirë politikanët që kryen kime lufte në periudhën e viteve 1998-2000» (kundrejt 6,2% në vitin 2017). Kështu, përshkrimi zyrtar i mandatit të GJSK-së nuk është mjaft i qartë pasi shumica e të anketuarve mendojnë se GJSK-ja do t'i ndjekë penalisht të gjithë autorët e dyshuar të kimeve të luftës gjatë Luftës në Kosovë.

3.2 Publiku e mbështetë ndjekjen penale të kimeve serioze por GJSK-ja është e padrejtë

Fig. 3.4

Sa e rëndësishme është ndjekja penale e kimeve të rënda të kryera në Kosovë në periudhën 1998-2000?




36,3% e të anketuarve treguan se ata mendojnë se është «shumë e rëndësishme» që krimet e rënda të kryera në Kosovë midis viteve 1998-2000 të ndiqen penalisht, e cila është më e lartë se 21,7% në vitin 2017. Gjithsej, 70,4% e të anketuarve mendojnë se është «deridiku» ose «shumë e rëndësishme», me 15,7% që e konsiderojnë «jo të rëndësishme» ose «aspak të rëndësishme»; në vitin vitin 2017 kjo ishte përkatësisht 58,4% dhe 33,2%. Kështu, në vitin 2020, një numër më i lartë i të anketuarve tregojnë se duan

ndjekje penale të kimeve të rënda të kryera gjatë dhe pas Luftës në Kosovë. Kur shikohet përkatësia etnike, ekziston një diferencë në mes të përqindjeve të të anketuarve që mendojnë se ndjekja penale e kimeve të rënda është «shumë e rëndësishme» ose «deridiku e rëndësishme», me 61,8% të serbëve-K që mendojnë se është «shumë e rëndësishme», krasuar me 31,2% e shqiptarëve-K dhe 37,5% e të tjerëve-K. Sidoqoftë, një shumicë e qartë e të gjitha grupeve etnike mendojnë se është «deridiku» deri në «shumë e rëndësishme»; 73,7% e shqiptarëve-K, 73,6% e serbëve-K dhe 77,5% e të tjerëve-K.

Fig. 3.5

Sipas mendimit tuaj, cilat lloje të kimeve të kryera gjatë dhe pas luftës 1998-1999 duhet të trajtohen?



Nga të gjithë të anketuarit, 42,4% janë të mendimit se është «e rëndësishme të trajtohen krimet e vuajtura nga të gjithë civilët» (rritje e lehtë nga 36,3% në vitin 2017), ndërsa 39,2% mendojnë se është «e rëndësishme të trajtohen krimet e vuajtura nga civilët shqiptarë» (kundrejt 43,4% në vitin 2017) dhe 7,6% e konsideron “të rëndësishme të trajtohen krimet e vuajtura nga civilët serbë” (kundrejt 11,2% në vitin 2017). Meqenëse dy përgjigjet e fundit nuk thanë se ishte e rëndësishme të trajtohen krimet e vuajtura nga *vetëm* një grup i caktuar etnik, ne i interpretojmë këto përgjigje me kuptimin që të anketuarit e konsiderojnë *veçanërisht* të rëndësishme t'i shkojnë krimet e vuajtura nga një grup i caktuar etnik. Sidoqoftë, duhet të theksohet se nuk kishte asnjë opsjon që i përfshinte të tjerët-K si një kategori e veçantë e viktimate civile.


Duke e marrë parasysh përkatësinë etnike të të anketuarve, 41,0% e shqiptarëve-K, 51,2% e serbëve-K dhe 68,3% e të tjerëve--K mendojnë se është «e rëndësishme të trajtohen krimet e vuajtura nga të gjithë civilët». Për më tepër, 42,0% e shqiptarëve-K mendojnë se është *veçanërisht* e rëndësishme «të trajtohen krimet e vuajtura nga civilët shqiptarë», ndërsa 20,9% e serbëve-K mendojnë se është *veçanërisht* «e rëndësishme të trajtohen krimet e vuajtura nga civilët serbë». Diku 27,9% e serbëve-K nuk e dinin ose nuk iu përgjigjën pyetjes. Këto të dhëna tregojnë se të anketuarit shqiptarë-K janë të ndarë në mënyrë të barabartë për rëndësinë e ndjekjes penale të kimeve kundër «të gjithë civilëve» ose kimeve kundër «në veçanti të civilëve shqiptarë-K». Një shpjegim mund të jetë se për shkak se GJSK-ja përqendrohet te autorët

shqiptarë-K të kimeve, ata mund të mendojnë se për viktimat shqiptare-K nuk do të vendoset drejtësia. Një raport së voni mbi perspektivat e qytetarëve për drejtësinë tranzicionale në Kosovë gjithashtu e shpalosi se njerëzit në përgjithësi dëshirojnë që krimet e rënda të ndiqen penalisht, por priren tu japos prioritet kimeve nga të cilat ka vuajtur më shumë grupi i tyre etnik.¹⁰⁰

Sa u përket grupmoshave, ekziston vetëm një ndryshim i jashtëzakonshëm; nga grupmosha mbi 65 vjeç, 31% mendojnë se është «e rëndësishme të trajtohen krimet e vuajtura nga të gjithë civilët», 46,9% mendojnë se është «e rëndësishme të trajtohen krimet e vuajtura nga civilët shqiptarë» dhe 8,8% e konsiderojnë «të rëndësishme të trajtohen krimet e vuajtura nga civilët serbë», duke treguar një tendencë të lehtë për ta favorizuar grupin e vet etnik, më shumë sesa në mesin e grupmoshave tjera [tabela 3].

Fig. 3.6

Gjykata Speciale e Kosovës do të ndjekë penalisht vetëm krimet e rënda të kryera në Kosovë në periudhën 1998-2000 të përshkruara në hetimin e vitit 2011 (Këshilli i Evropës “Raporti i Dik Martit”), i cili kryesish mbalon krimet e pretenduara të lidhura me Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Si e shihni ju këtë marrëveshje?



Nga të gjithë të anketuarit, 71,2% mendojnë se është e padrejtë që GJSK-ja t'i ndjekë penalisht vetëm krimet e rënda të kryera në Kosovë në periudhën e viteve 1998-2000, të përshkruara në Raportin e Marty, i cili kryesish i mbalon krimet e pretenduara që lidhen me Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës (kjo ishte 74,3% në vitin 2017) Vetëm 16,2% mendojnë se është e drejtë (e ngjashme me 16,7% në vitin 2017). Nuk është përtu habitur, kur shikohen përkatësitë etnike të të anketuarve, dallimet e mëdha në opinion tregojnë: 56,0% e serbëve-K dhe 40,0% e të tjerve-K e konsiderojnë të drejtë se GJSK-ja kryesish i ndjekë penalisht krimet që lidhen me UÇK-në, ndërsa vetëm 16,4% e shqiptarëve-K janë të të njëjtit mendim. Në vitin 2017, këto përqindje ishin përkatësish 45,5%, 26,7% dhe 15,0%. Kjo mund të shpjegohet me faktin se në përgjithësi, secili grup etnik e konsideron veten viktimi kryesore të Luftës në Kosovë ose e pasojave të saj, ndërsa të tjerët i konsiderojnë si autorë të kimeve.¹⁰¹ Më shumë gra (21,4%) sesa burra (15,8%) e shohin mandatin e GJSK-së si një aranzhim të drejtë [tabela 4].


100 Visoka, Gëzim & Lumi, Besart, ‘Perspektiva e Qytetarëve mbi një Strategji të Ardhshme për Drejtësinë Tranzicionale në Kosovë’, janar, 2021; <https://www.paxforpeace.nl/publications/all-publications/citizens-perspective-on-a-future-strategy-for-transitional-justice-in-kosovo>

101 Po aty.

3.3 Besimi se GJSK-ja do të vendosë drejtësi mbetet i ulët

Fig. 3.7

Sa i besoni Gjykatës Speciale të Kosovës për të vendosur drejtësi për viktimat e kimeve të rënda të kryera në periudhën 1998-2000?




Ka më shumë të anketuar (53%) që «deridiku nuk besojnë» ose «aspak nuk besojnë» se GJSK-ja do të vendosë drejtësi për viktimat e kimeve të rënda, të kryera në periudhën e viteve 1998-2000, sesa ata (38,2%) të cilët «deridiku» ose «tërësisht besojnë» se GJSK-ja do ta bëjë këtë. Kjo është e jashtëzakonshme pasi në vitin 2017 kjo ishte e kundërtë me 58,7% që besonin se GJSK-ja do të vendoste drejtësi për viktimat, dhe 32,3% të cilët i kishin dyshimet e tyre.¹⁰² Në përgjithësi, të anketuarit serbë-K duket se i kanë dyshimet më të forta rreth asaj nëse GJSK-ja mund të vendosë drejtësi për viktimat me 55,8% që dyshojnë në këtë («deridiku» dhe «aspak») dhe vetëm 7,0% «deridiku e besojnë» këtë, me mbi një të tretën e tyre që nuk i janë përgjigjur kësaj pyetjeje. Sidoqoftë, besimi në mesin e serbëve-K në fakt është rritur pak pasi në vitin 2017, 69% dyshon që GJSK-ja do të vendoste drejtësi. Në të njëjtën kohë, besimi në mesin e të anketuarve shqiptarë është zvogëluar, me 39,0% që ose «deridiku» ose «tërësisht besojnë» se GJSK-ja mund të vendosë drejtësi, kundrejt 60% në vitin 2017. Ndërt tjetër-K, besimi është pak më i ulët, me 51,2% të tyre me ose «deridiku» ose «tërësisht besojnë» se GJSK-ja mund të vendosë drejtësi për viktimat e kimeve të rënda, të kryera në periudhën 1998-2000, kundrejt 58,4% në vitin 2017. Ky besim i përgjithshëm i zvogëluar në GJSK-në përfundon drejtësi për viktimat, mund të shpjegohet me faktin se besimi i përgjithshëm në mekanizmat e drejtësisë është i ulët në Kosovë dhe pritja e gjatë pë aktakuza nga GJSK-ja i ka bërë njerëzit më dyshues dhe më shpërfillës. Ndryshimi kryesor i vërejtur këtu është se besimi midis shqiptarëve në aftësinë e GJSK-së përfundon drejtësi ka rënë qartë, ndërsa te serbët është ngritur pak. Kjo mund të ketë të bëjë me konstatimin se shumica e shqiptarëve-K e shohin mandatin e GJSK-së si të padrejtë, ndërsa mbi gjysma e serbëve-K e konsiderojnë mandatin si të drejtë.

102 Shënim: të dhëna nga studimi i të dhënave të papërpunuara për Perceptimin Publik mbi Gjykatën Speciale të Kosovës: Rezjetet dhe Mundësitet; 2017; në këtë raport prezantohen vetëm të dhënat e ndara sipas përkatësisë etnike.

Fig. 3.8

A është formimi i Gjykatës Speciale (aktakuzat, gjykimet dhe dënimet e mundshme) diçka e mirë apo diçka e keqe për Kosovën?




Aktualisht, më shumë njerëz (50,6%) mendojnë se GJSK-ja është një gjë e keqe për Kosovën sësaj një gjë e mirë (24,4%), ndërsa në vitin 2017 kjo ishte anasjelltas me 39,0% kundrejt 42,2%, përkatësisht. Kur i shikojmë grupmoshat, është e jashtëzakonshme të theksohet se 60,2% e të anketuarve më të rinj (18-24 vjeç) mendojnë se GJSK-ja është një gjë e keqe për Kosovën, me vetëm 19,9% të tyre që mendojnë se është një gjë e mirë [tabela 5].

Shumë serbë-K (41,9%) nuk e dinë nëse GJSK-ja është diçka e mirë apo e keqe, ndërsa 48,4% e serbëve-K presin që GJSK-ja të jetë diçka e mirë, dhe 9,7% e serbëve-K mendojnë se është një gjë e keqe. Poashtu, 46,2% e të tjerëve-K mendojnë se GJSK-ja është diçka e mirë, ndërsa një e treta e tyre mendon se është diçka e keqe. Për shqiptarët-K shifrat janë anasjelltas, me 24,7% që mendojnë se është diçka e mirë dhe 56,9% që e shohin GJSK-në si një gjë të keqe për Kosovën. Kjo korrespondon me shifrat për «drejtësi» të mandatit të GJSK-së, që nga shumica e shqiptarëve konsiderohet si e padrejtë.

Fig. 3.9

Cila është arsyёja kryesore që ju mendoni se Gjykata e Speciale është një gjë E MIRË pёr Kosovën?




Vetëm 38,6% e të anketuarve iu përgjigjën kësaj pyetjeje (pasi atyre që mendojnë se GJSK-ja është gjë e keqe nuk iu është bërë kjo pyetje). Arsyet kryesore të dhëna pse ata menduan se GJSK-ja është një gjë e mirë pёr Kosovën janë se «jo do t'i sjellë para drejtësisë autorët e krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit të kryera në Kosovë gjatë viteve 1998-2000» (21,6%) dhe se «Kjo do të ndihmojë ta përmirësojë sundimin e ligjit në Kosovë» (12,7%). Shumë pak të anketuar menduan se 'Do t'i normalizojë marrëdhënet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë' (2,1%) ose se 'do t'i normalizojë marrëdhënet në mes të serbëve të Kosovës dhe shqiptarëve të Kosovës' (1,7%).

Ka një ndryshim në përgjigje kur shikohet përkatësia etnike; nga ata që mendojnë se GJSK-ja është një gjë e mirë, 65,2% e të tjerëve-K dhe 67,9% e serbëve-K besojnë se «kjo do t'i sjellë para drejtësisë autorët e krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit të kryera në Kosovë gjatë viteve 1998-2000», me 54,6% të shqiptarëve-K që u përgjigjën kështu. Një përqindje tjetër prej 34,9% e shqiptarëve-K që mendojnë se GJSK-ja është një gjë e mirë, besojnë se «kjo do të ndihmojë në përmirësimin e sundimit të ligjit në Kosovë», ndërsa 26,1% e të tjerëve-K dhe 10,7% e serbëve-K e dhanë këtë si arsyёja kryesore pёr të menduar se GJSK-ja është një gjë e mirë pёr Kosovën. Gjithashtu, 10,7% e serbëve-K dhe 8,7% e të tjerëve-K të cilët mendojnë se GJSK-ja është diçka e mirë, mendojnë kështu sepse «Kjo do t'i normalizojë marrëdhënet në mes të serbëve të Kosovës dhe shqiptarëve të Kosovës», ndërsa vetëm 3,6% e shqiptarëve-K që mendojnë se GJSK-ja është një gjë e mirë, e dhanë këtë përgjigje si arsyen kryesore.

Fig. 3.10

Cila është arsyёja kryesore që ju mendoni se Gjykata e Speciale është një gjë gjë E KEQE për Kosovën?




Kjo pyetje iu shtrua të gjithë të anketuarve. Arsyet kryesore të dhëna janë se «është drejtësi e njëanshme» (51,0%) dhe se «jo të gjithë autorët e krimeve të luftës do të sjellen para drejtësisë» (33,3%). Një përqindje shumë më e vogël prej 9,7% mendon se ‘është thjeshtë një lojë ndërkombetatare’ dhe 5,5% mendon se ‘marrëdhënia në mes të serbëve të Kosovës dhe shqiptarëve të Kosovës do të përkeqësohet’. Kur zbërthehen të dhënat sipas përkatësisë etnike, dukshëm më shumë shqiptarë-K (53,9%) mendojnë se GJSK-ja është diçka e keqe sepse «është drejtësi e njëanshme» sesa të tjerët-K (31,1%) ose serbët-K (6,8%). Në të njëjtën kohë, më shumë serbë-K (61,4%) e shohin GJSK-në si një gjë të keqe sepse «jo të gjithë autorët e krimeve të luftës do të sillen para drejtësisë», sesa të tjerët-K (48,8%) ose shqiptarët-K (31,6%). Gjithashtu, studimi i përceptimit i vitit 2017 shpalosi se serbët-K janë shumë skeptikë në lidhje me aftësinë e GJSK-së për të ndjekur penalisht mjaftueshmë raste, pasi gjykatat e tjera ndërkombetatare dhe ato nacionale nuk ia kanë dalur dot.¹⁰³ Më tej, 22,7% e serbëve-K e shohin GJSK-në si një gjë të keqe sepse ata mendojnë se ‘marrëdhënia në mes të serbëve të Kosovës dhe shqiptarëve të Kosovës do të përkeqësohet’, ndërsa vetëm 4,9% e të tjerëve-K dhe 4,8% e shqiptarëve-K e shohin atë si një arsyre kryesore për ta konsideruar GJSK-në si një gjë të keqe për Kosovën. Ky ndryshim në ndikimin e pritshëm negativ në marrëdhëniat ndëretnike mund të jetë një shprehje e frikës për këtë nga ana e serbëve-K që janë një pakicë dhe në narrativën mbizotëruese politike fajësohen si grup. Për shumicën e shqiptarëve-K, përkeqësimi i mundshëm i marrëdhënieve me serbët duket se është më pak shqetësues.

103 Warren et al. (2017), f. 15-16.

Fig. 3.11

Sa jeni të interesuar në procesin e punës së Gjykatës Speciale?



Pak më shumë të anketuar janë “(shumë) të interesuar” me 48,4% duke iu përgjigjur kësaj pyetjeje, sesa 45,6% që tregojnë se nuk janë “të interesuar (aspak)”. Sidoqoftë, në vitin 2017 interesë ishte pak më i lartë me 56,8% «(shumë) të interesuar» dhe 41,8% «jo të interesuar (aspak)». Shqiptarët-K (52,1%) janë pak më të interesuar sesa serbët-K (47,1%) ose të tjerët-K (41,0%). Më shumë burra (56,9%) sesa gra (45,7%) janë “(shumë) të interesuar” [tabela 6].

Cili është burimi më i besueshëm i informacionit në lidhje me proceset / gjykimet që do të zhvillohen në Gjykatën Speciale?

Të anketuarit kanë mundur të jepin përgjigje të shumëfishta për këtë pyetje. Në përgjithësi, shumë të anketuar e konsiderojnë që media është një burim i besueshëm i informacionit (duke shënuar 51,5%). Në anketë nuk është bërë ndarja e mediave dhe në këtë mënyrë nuk mund të bëhet vlerësim i qartë mbi besueshmërinë e mediave të përdorura nga të anketuarit. Megjithëse në përgjithësi, media në Kosovë është e ndarë përgjatë vijave etnike dhe «qasja në informacion shpesh është e kufizuar për një grup etnik ose politik, me shumicën e mediave që raportojnë kryesisht për çështje që lidhen me kombësinë e tyre». ¹⁰⁴ Në vitin 2017, media u përmend shumë më pak, duke arritur vetëm 25,9% [tabela 7.1]. Meqenëse, besimi te burimet e tjera të informacionit është zvogëluar pak; besimi në deklaratat e zyrtarëve të GJSK-së shkoi nga 13,1% në vitin 2017, në 8,4% në vitin 2020; besimi në faqen e internetit të GJSK-së shkoi nga 9,9% në 6,3%; raportet e pavarura të gazetarëve hulumtues shkuan nga 14,7% në 5,8%; deklaratat e përfaqësuesve ndërkombëtarë ranë nga 9,8% në 3,4%. Në të njëjtën kohë, edhe besimi i përgjithshëm në deklaratat e

104 Kosova rangohet me nr. 70 nga 180 në Indeksin Botëror të Lirisë së Shtypit 2020 të Gazetarëve pa Kufij; <https://rsf.org/en/kosovo>; Në rangimin e Freedom House “Kombet në tranzit 2020”, Kosova shënon shkallën 3,25 nga 7 shkallët për liri të shtypit; <https://freedomhouse.org/country/kosovo>. Në dhjetor të vitit 2020, Radio Kosova, transmetues publik, refuzoi ta transmetonte tregimin e një gruaje serbe në një seri prej dhjetë rrëfimesh të audio dramave ‘Të jetosh me kujtimet e të zhdukurve’, pasi konsideronte se episodi kishte “gjuhë linçimi kundër shqiptarëve”; KOHA Ditore, ‘Radio Kosova ndërpret transmetimin e audio dramave pas rrëfimit të gruas serbe’, 12 janar, 2021; <https://www.koha.net/kulture/253900/radio-kosova-nderpreth-transmetimin-e-audio-dramave-pas-rrëfimit-te-gruas-serbe/?fbclid=IwAR1w1xqytr6TogmaXcfHDW01Nqh2fcE1gvoPABAW1o9B1GxQEmZE6L0wc4>

politikanëve mbeti relativisht i ulët. Nuk është për tu habitur që besimi në deklaratat nga politikanët shqiptarë-K vjen nga të anketuarit shqiptarë dhe të tjerët-K (përkatësisht 11,4% dhe 13,5%) dhe jo nga serbët-K, ndërsa deklaratat e politikanëve serbë besohen nga 31,2% e të intervistuarve serbë-K, të cilët iu përgjigjën pyetjes (22,9% e serbëve-K nuk i janë përgjigjur) por shumë pak nga shqiptarët-K apo të tjerët-K [tabela 7.1]. Për më tepër, përderisa shqiptarët-K (79,6%) dhe të tjerët-K (75,4%) tregojnë besim të fortë në media si një burim i besueshëm i informacioni, për serbët-K kjo është disi më e ulët, me 51,0%. Besimi në GJSK-në si burim i informacionit mbetet relativisht i ulët, me 14,5% (të tjerë-K), 22,6% (shqiptarë-K) dhe 23,9% (serbë-K).

Si përmbledhje, ky studim i shkurtër i pëceptimit tregon se njohuritë dhe ndjenjat e përgjithshme në Kosovë rreth GJSK-së nuk kanë ndryshuar shumë që nga viti 2017. Ka ende shumë pak kuptim në mesin e qytetarëve për mandatin aktual dhe qëllimin e GJSK-së; vetëm rreth një e treta e të gjithë të anketuarve e dinë se ka të bëjë diçka me krimet e luftës ose krimet e rënda që raportohet se kanë lidhje me UÇK-në. Në përgjithësi, qytetarët duan që krimet e rënda kundër të gjithë qytetarëve të ndiqen penalisht, megjithëse ekziston gjithashtu një preferencë thelbësore që krimet e kryera kundër grupeve specifike të viktimate - të lidhura me grupin e vet etnik - të ndiqen penalisht. Duket se shtrirja e shtuar e komunikimit të GJSK-së nuk arriti ta ndryshojë diskursin e përgjithshëm publik rreth GJSK-së, pjesërisht si rezultat i dominimit të një kundër-diskursi të fortë në mesin e elitës politike dhe mediave në Kosovë. Për më tepër, të gjeturat tregojnë për një besim të ulët në GJSK-në për të vendosur drejtësi te shqiptarët-K, ndërsa te serbët-K kjo është rritur pak. Kjo mund të jetë rezultat i ndikimit më të fortë të diskursit etno-nationalist rreth thirrjes në vitin 2019 dhe 2020, me shumicën e shqiptarëve-K që mendojnë se mandati i GJSK-së është i padrejtë, ndërsa shumë serbë-K dhe të tjerë-K e konsiderojnë atë të drejtë. Në të njëjtën kohë, dallimet e shprehura në besim tregojnë për gjasat që grupe të ndryshme etnike t'i shohin ndryshe rezultatet e punës së GJSK-së. Nëse ky mund të jetë një problem real, do të varet nga mënyra se si do të jetë në gjendje GJSK-ja t'i shpjegojë procedurat gjyqësore në një kontekst të politikës së polarizuar rreth saj.

4. Përfundimet dhe rekoman- dimet

Origjina e Gjykatës Speciale të Kosovës nuk ishte vetëm një vlerësim gjyqësor por edhe politik. Nga ajo perspektivë, GJSK-së iu dha një mandat i cili ka qenë kontradiktor që në fazat e tij të hershme pasi që merret kryesisht, ose vetëm, me krimet e pretenduara të lidhura me një palë në Luftën në Kosovë të viteve 1998/99. Duke e parë atë nga një perspektivë e pastër e ligjit ndërkombëtar ose e të drejtave të njeriut, krimet e rënda të luftës dhe krimet kundër njerëzimit të pretenduara në raportin e hetimit penal të TFSH-së, duhet të ndiqen penalisht. Kjo është e padiskutueshme pasi viktimat e këtyre krimeve meritojnë që të vendoset drejtësia. Në këtë mënyrë, krijimi i GJSK-së si një gjykatë hibride, duke e kombinuar ligjin e brendshëm të Kosovës dhe të drejtën ndërkombëtare humanitare, dhe të qenit me staf ndërkombëtar, është e kuptueshme. Sidoqoftë, fakti që fokusi i GJSK-së është te njëra palë në konflikt e bën punën e saj kontradiktore dhe të prirur të përdoret në diskurset mbizotëruese etno-politike të viktimave-autorëve të krimeve në Kosovë - dhe Serbi. Nëse ato vazhdojnë të jenë mbizotëruese, çdo autor i dënuar i krimeve ka të ngjarë të konsiderohet si 'hero çlirimtar' nga shumë shqiptarë-K. Në Serbi, dënimet e ardhshme nga GJSK-ja do ta konfirmojnë narrativën e tyre se UÇK-ja ishte një ndërmarrje kriminale dhe si e tillë Kosovës kurrë nuk do të duhej t'i ishte dhënë mundësia për ta shpallur pavarësinë e saj.

Nga pikëpamja e drejtësisë tranzicionale, fokusi i njëanshëm i mandatit të GJSK-së është një mohim i asaj që dihet për trajektoret përfshirëse të përcaktuara mirë të drejtësisë shpaguese si komponent i proceseve të drejtësisë tranzicionale. Gjithashtu, fakti që GJSK-ja nuk ka prani të përhershme lokale në Kosovë – edhe pse kjo ishte parashikuar në fillim - nuk e ndihmon vizibilitetin e saj, marrëdhëni dhe rrjedhimisht legjitimitetin e saj në nivel lokal. Aktualisht, GJSK-ja dhe Departamenti i Krimeve të Luftës i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK) janë mekanizmat e vetëm në nivel nacional që e adresojnë të kaluarën e luftës; që të dyja mekanizma thjesht ndëshkues të drejtësisë, me mandate të kufizuara (gjeografikisht). Për ironi të fatit, GJSK-ja mund të provojë të jetë efektive në një dimension tjeter të drejtësisë tranzicionale: reformën institucionale, duke marrë ndoshta liderë të korruptuar nga sistemi politik. E vëtmja përpjekje tjeter serioze dhe e vazhdueshme përtu marrë me të kaluarën e luftës është vërtetimi i së vërtetës përrreth 1642 persona që janë ende të zhdukur.

Fokusi mbizotërues në gjykimet e krimeve të luftës ka ndikuar në vëmendjen dhe investimet në aspekte tjera të rëndësishme të ballafaqimit me të kaluarën në Kosovë, të tilla si: kërkimi i së vërtetës dhe dokumentimi, përkujtimi, dëmshpérblimet dhe kompensimi, si dhe njohja dhe mbështetja për të gjitha viktimat dhe të mbijetuarit e konfliktit, pavarësisht nga identiteti dhe statusi i tyre. Të gjitha këto dimensione të DT-së duhet të adresohen në vëtvete përtu ta ndihmuar shoqërinë kosovare të shkojë drejt një shoqërie më gjithëpërfshirëse dhe paqësore. Në dritën e procedurave aktuale nga GJSK-ja, është koha që qeveria e Kosovës dhe mbështetësit e saj ndërkombëtarë të investojnë në një qasje gjithëpërfshirëse përtu ballafaquar me të kaluarën.

Disa nga rekomandimet e bëra në vitin 2017 janë ende relevante sot.

GJYKATA SPECIALE E KOSOVËS DUHET TË:

- ◆ Intensifikoj programin për shtrirjen e komunikimit dhe dialogut publik në Kosovë, Serbi dhe vendet e tjera në Ballkanin Perëndimor, për:
 - ◆ ta shpjeguar qartë origjinën dhe mandatin e GJSK-së, përfshirë edhe sqarimin e kufizimeve të saj;
 - ta shpjeguar dallimin në mes të roleve të Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit Special;
 - t'u përgjigjur publikisht në kohën e duhur mbi zhvillimet rreth punës së GJSK-së.
- ◆ Rishqyrtoj krijimin e një pranie të përhershme të Dhomave të Specializuara në Kosovë, për ta rritur vizibilitetin dhe përfundimtarisht marrëdhënien më të drejtpërdrejta me komunitetet e viktimate;
- ◆ Siguroj aktakuza dhe gjykime me kohë dhe efektive, në përputhje të plotë me ligjet në fuqi.
- ◆ Shmangë çdo dyshim për ndikim politik ose paragjykim mbi vendimet dhe procedurat e GJSK-së.
- ◆ Zhvilloj një strategji daljeje, duke siguar që kur GJSK-ja t'i përfundojë operimet e saj, informacioni publik dhe aktivitetet e dialogut rreth procedurave dhe rezultateve t'i dorëzohen qeverisë së Kosovës dhe në mënyrë integruese të jenë në dispozicion të shoqërisë civile kosovare, komunitetit ligjor lokal dhe mediave lokale, me fonde dhe kapacitete të përshtatshme.

QEVERIA E KOSOVËS DUHET TË:

- ◆ Marrë përgjegjësi për GJSK-në si pjesë e sistemit ligjor të Kosovës dhe të bashkëpunojë plotësisht për të siguruar që të vendoset drejtësia për viktimat, përfshirë sigurimin e mbrojtjes së dëshmitarëve dhe viktimate;
- ◆ Ndajë politikën aktuale nga e kaluara e luftës, përmes adoptimit të një qasjeje etike për t'u ballafaquar me të kaluarën;
- ◆ Tregojë zotim të sinqertë ndaj kërkesës së Komisionit Evropian për të zhvilluar një strategji gjithëpërfshirëse për drejtësinë tranzicionale si pjesë e procesit të anëtarësimit në BE, përmes:
 - Investimit në zhvillimin e një infrastrukturë me diskutim të hapur për ballafaqimin me të kaluarën (IPBmK) në Kosovë¹⁰⁵, të përbëra nga elementet si në vijim:
 - Një vizion strategjik dhe mirëkuptim nacional i informuar nga qytetarët mbi parimet dhe etikën për ballafaqimin me të kaluarën dhe ndjekjen e drejtësisë tranzicionale në Kosovë. Kjo duhet të përfshijë 1) primatin në qasjet e përqendruara te viktimat dhe te të mbijetuarit, 2) barazinë dhe ndjeshmérinë më të madhe gjinore, dhe 3) de-etnizimin, de-politizimin, dhe de-personalizimin e iniciativave të BmK-së;
 - Një bazë të integruar të njojurive dhe një depo të strategjive ekzistuese specifike të sektorit, iniciativave dhe mekanizmave për drejtësinë tranzicionale dhe BmK-në në Kosovë;
 - Një strategji kombëtare për drejtësinë tranzicionale që i integron katër shtyllat, e përcaktuara gjërësisht, të drejtësisë tranzicionale; gjykimet e krimeve të luftës, kërkimin e së vërtetës, dëmshpërblimet dhe garancitë e mos përsëritjes përmes

105 Për detaje mbi këtë infrastrukturë për t'u bme të kaluarën (IPBmK) shih Visoka & Lumi (2020), f. 32-41.

- reformave institucionale. Kjo strategji duhet të informohet nga nevojat dhe interesat e qytetarëve dhe të zhvillohet nga një proces i hapur për diskutim, gjithëpërfshirës dhe nga poshtë-lart;
- Një infrastrukturë institucionale të integruar për ballafaqimin me të kaluarën, e cila funksionon si një infrastrukturë institucionale ombrellë, përgjegjëse për mbështetjen e nismave ekzistuese dhe të ardhme për ballafaqimin me të kaluarën në Kosovë;
 - ◆ Themeloj një komision parlamentar për ballafaqimin me të kaluarën që ka për detyrë monitorimin dhe raportimin mbi progresin e qeverisë;
 - ◆ Investoj menjëherë në ngritjen e kapaciteteve dhe pavarësinë e gjyqësorit në Kosovë për t'u marrë me krimet e luftës, krimet kundër njerëzimit dhe krime tjera të rënda. Si pjesë e kësaj, mbrojtja e viktimave dhe dëshmitarëve duhet të forcohet.

BE-ja DHE AKTORËT KYÇ NDËRKOMBËTARË NË KOSOVË DUHET TË:

- ◆ Mbështesin një përpjekje të fortë dhe gjithëpërfshirëse për BmK-në në Kosovë duke investuar resurse politike, burokratike dhe financiare në promovimin e një kornize kombëtare për ballafaqimin me të kaluarën e luftës, në mënyrë që Kosova t'i përmبushë kërkosat e Komisionit Evropian;
- ◆ Dialogu i udhëhequr nga BE-ja për normalizimin e marrëdhënieve midis Serbisë dhe Kosovës duhet t'i adresojë çështjet e ngutshme dhe të pazgjidhura për ballafaqimin me të kaluarën dhe një marrëveshje eventuale duhet t'i marrë parasysh nevojat dhe perspektivat e të gjitha komuniteteve të prekura;
- ◆ Monitorojnë progresin e Kosovës dhe Serbisë në ballafaqimin me të kaluarën dhe në praktikat përfshirëse të drejtësisë tranzicionale, në mënyrë eksplikite, si pjesë e procesit të tyre të anëtarësimit në BE;
- ◆ Dyfishtojnë përpjekjet për të siguruar që ndihma juridike e ndërsjellë ndërmjet Kosovës dhe Serbisë në hetimin e kimeve të luftës të funksionojë;
- ◆ Vazhdojnë mbështetjen për realizimin e pavarësisë së gjyqësorit në Kosovë dhe rritjen e kapaciteteve të institucioneve lokale në Kosovë dhe Serbi për t'u marrë me krimet e luftës.
- ◆ Forcojnë më tej mbështetjen financiare për të nxitur projekte lokale dhe ndërkufitarë të drejtësisë tranzicionale, si dhe ta prioritojnë drejtësinë tranzicionale në projekte të tjera të shoqërisë civile të finançuara nga BE-ja;
- ◆ Njohin dhe shpërblenë punën e institucioneve të Kosovës që e mbështesin GJSK-në, për shembull duke i avancuar perspektivat për liberalizimin e vizave, duke e avancuar procesin e integrimit evropian të Kosovës dhe duke i mbështetur përpjekjet diplomatike të Kosovës për të siguruar njohje relevante dhe për t'u anëtarësuar në organizatat ndërkombëtare dhe rajonale;

SHOQËRIA CIVILE NË KOSOVË DUHET TË:

- ◆ Vazhdojë të punojë me ekipin e shtrirjes së komunikimit të GJSK-së për të arritur komunikim transparent dhe korrekt dhe shpërndarje të informacionit në shoqërinë e gjerë të Kosovës, për t'i zbutur efektet e mundshme të padëshiruara;
- ◆ Të punojnë së bashku në një koalicion për avancimin e një strategjie kombëtare gjithëpërfshirëse për drejtësinë tranzicionale në Kosovë që ka në qendër qytetarin, përmes angazhimit me komunitete të ndryshme të viktimave, lobit të përbashkët drejt qeverisë dhe aktorëve ndërkombëtarë;
- ◆ Investojë në ngritjen e kapaciteteve dhe në fushata efektive dhe të qëndrueshme të komunikimit që i luftojnë narrativat nacionaliste dhe përjashtuese.

SHTOJCA 1

Studimi i Përceptimit të Publikut 2020

Qëllimi i këtij pyetësori është të pyesë qytetarët e Kosovës në lidhje me njohuritë dhe përceptimet e tyre për Dhomat e Specializuara të Kosovës dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, referuar më poshtë si Gjykatë Speciale e Kosovës.

I. NJOHURITË E QYTETARËVE MBI QËLLIMIN DHE ROLIN E GJYKATËS SPECIALE

Fillimisht, ne duam të ju bëjmë disa pyetje rreth rolit dhe qëllimit të Gjykatës Speciale dhe burimet e informimit

1. Sa e konsideroni vetën të informuar rreth Gjykatës Speciale?

- a) Shumë i/e informuar
- b) Deri diku i/e informuar
- c) Deri diku i/e painformuar
- d) Aspak i/e informuar [Kalo në P4]
- e) Pa përgjigje/Refuzoj

2. Sipas mendimit tuaj, cili është qëllimi i përgjithshëm i Gjykatës Speciale?

3. Nga cilat burime keni marrë informata për Gjykatën Speciale, deri më tanë? [Përgjigje e shumëfishtë]

- a) Gazetat e shkruara
- b) Portalet Online
- c) Rrjetet Sociale(Facebook,Twitter,etj)
- d) Televizioni
- e) Radio
- f) Organizatat e Shoqërisë Civile (OshC) /Organizatat Jo-Qeveritare (OJQ)
- g) Raportet e pavarura të gazetarëve hulumtues
- h) Drejtpërdrejt nga Ekipi i Ndihmës për Dhomat e Specializuara të Kosovës
- i) Webfaqja e Gjykatës së Specializuar dhe / ose deklaratat e zyrtarëve të Gjykatës së Specializuar (Kryeprokurori, Kryetari ose Regjistruesi i Dhomave të Specializuara)
- j) Deklaratat e plotikanëve shqiptarë të Kosovës
- k) Deklaratat e plotikanëve Serb
- l) Deklaratat e përfaqësuesve ndërkombëtarë (BE dhe ambasadat)
- m) EULEX
- n) Fjalët e njerëzve
- o) Tjetër, ju lutem specifiko _____
- p) Nuk e di

4. Gjykata Speciale ka një mandat dhe juridikcion specifik mbi krimet kundër njerëzimit, krimet e luftës dhe kime të tjera sipas ligjit të Kosovës, të cilat janë kryer në Kosovë ndërmjet 1 Janar 1998 dhe 31 Dhjetor 2000, nga ose kundër qytetarëve të Kosovës ose Republikës Federale të Jugosllavisë. Kush mendoni se janë njerëzit që me gjasë do t'i nënshtronen ndjekjes penale nga Gjykata Speciale?

- a) Personat që kanë kryer kime luftë në periudhën 1998-2000, përfshirë politikanët, pavarësisht nga përkatësia e tyre etnike
- b) Serbët e Kosovës, duke përfshirë politikanët serbë të cilët kanë kryer kime luftë në periudhën 1998-2000
- c) Shqiptarët e Kosovës, duke përfshirë politikanët shqiptarë të cilët kanë kryer kime luftë në periudhën 1998-2000
- d) Tjetër, ju lutem specifiko _____
- e) Nuk e di
- f) Pa përgjigje/Refuzoj

II. QËNDRIMET DHE PRITJET E QYTETARËVE NDAJ THEMELIMIT DHE FUKSIONIMIT TË GJYKATËS SPECIALE

Pyetjet e radhës janë në lidhje me qëndrimet dhe pritjet e juaja ndaj Gjykatës Speciale. Ju lutem mos harroni që çdo gjë që thoni është plotësisht konfidenciale dhe do të na ndihmojë shumë për të kuptuar perceptimet e njerëzve për Gjykatën Speciale.

5. Sa e rëndësishme është ndjekja penale e kimeve të rënda të kryera në Kosovë në periudhën 1998-2000??

- a) Shumë e rëndësishme
- b) Deri diku e rëndësishme
- c) E parëndësishme
- d) Aspak e rëndësishme
- e) Nuk e di
- f) Pa përgjigje/Refuzoj

6. Sipas mendimit tuaj, cilat lloje të kimeve të kryera gjatë dhe pas luftës 1998-1999 duhet të trajtohen?

- a) E rëndësishme të trajtohen krimet që i kanë vuajtur civilët shqiptarë
- b) E rëndësishme të trajtohen krimet që i kanë vuajtur civilët serbë
- c) E rëndësishme të trajtohen krimet që i kanë vuajtur të gjithë civilët
- d) Nuk e di/Pa përgjigje

7. Gjykata Speciale e Kosovës do të ndjekë penalisht vetëm krimet e rënda të kryera në Kosovë në periudhën 1998-2000 të përshkruara në hetimin e vitit 2011 (Këshilli i Evropës «Raporti i Dik Martit»), i cili kryesisht mbulon krimet e pretenduara të lidhura me Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Si e shihni ju këtë marrëveshje?

- a) E drejtë
- b) E padrejtë
- c) Pa përgjigje/Refuzoj

8. Sa i besoni Gjykatës Speciale të Kosovës për të vendosur drejtësi për viktimat e kimeve të rënda të kryera në periudhën 1998-2000?

- a) Shumë e mundshme
- b) Deri diku e mundshme
- c) Deri diku e pamundshme
- d) Shumë e pamundshme
- e) Nuk e di/Pa përgjigje

9. A është formimi i Gjykatës Speciale (aktakuzat, gjykimet dhe dënimet e mundshme) diçka e mirë apo diçka e keqe për Kosovën?

- a) Diçka e mirë [Kalo në P10]
- b) Diçka e keqe [Kalo në P11]
- c) Nuk e di
- d) Pa përgjigje/Refuzoj

10. Cila është arsyja kryesore që ju mendoni se Gjykata e Speciale është një gjë e mirë për Kosovën?

- a) Do të sjellë para drejtësisë autorët e kimeve të luftës dhe kimeve kundër njerëzimit të kryera në Kosovë gjatë viteve 1998-2000
- b) Do të ndihmojë në përmirësimin e sundimit të ligjit në Kosovë
- c) Do të normalizojë marrëdhëniet ndërmjet serbëve të Kosovës dhe shqiptarëve të Kosovës
- d) Do të normalizojë marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë
- e) Tjetër, ju lutem specifiko _____
- f) Nuk e di/Pa përgjigje

11. Cila është arsyja kryesore që ju mendoni se Gjykata e Speciale është një gjë e keqe për Kosovën?

- a) Është drejtësi e njëanshme
- b) Jo të gjithë autorët e kimeve të luftës dhe kimeve kundër njerëzimit të kryera në Kosovë gjatë viteve 1998-2000 do të sjellen para drejtësisë
- c) Është thjeshtë një lojë ndërkonbëtare
- d) Raporti ndërmjet serbëve të Kosovës dhe shqiptarëve të Kosovës do të përkeqësohet

III. BURIMET DHE CILËSIA E INFORMATAVE MBI GJYKATËN SPECIALE

Ne jemi duke përparuar. Kjo pjesë do të ketë pyetje në lidhje me burimet dhe cilësinë e informacionit të ofruara për publikun mbi Gjykatën Speciale.

12. Sa jeni të interesuar në procesin e punës së Gjykatës Speciale?

- a) Shumë të interesuar
- b) Të interesuar
- c) Të painteresuar
- d) Aspak të interesuar
- e) Pa përgjigje/Refuzoj

13. Cili është burimi më i besueshëm i informacionit në lidhje me proceset / gjykimet që do të zhvillohen në Gjykatën e Speciale ? [Përgjigje e shumëfishtë]

- a) Webfaqja e Gjykatës Speciale
- b) Deklaratat e zyrtarëve të Gjykatës Speciale (Kryeprokurori, Presidenti apo Sekretari i Dhomave të Specializuara)
- c) Procedurat gjyqësore dhe dëshmitë e viktimave
- d) Mediat
- e) OJQ-të
- f) Raportet e pavarura te gazetarisë hulumtuese
- g) Deklaratat e politikanëve Shqiptarë
- h) Deklaratat e politikanëve Serbë
- i) Deklaratat e përfaqësuesve ndërkombëtarë, duke përfshirë BE-në dhe ambasadat
- j) EULEX
- k) Tjetër, ju lutem specifiko _____
- l) Pa përgjigje/refuzoj

SHTOJCA 2

Tabelat me të dhëna të Studimit të Përceptimit të Publikut

Sa e konsideroni veten të informuar mbi Gjykatën Speciale të Kosovës?

Tabela 1.1

GJINIA (2020)	MASHKULL	FEMËR	GJITHSEJ
Shumë të informuar	3,7%	1,9%	2,9%
Deridiku të informuar	40,0%	23,8%	32,1%
Deridiku të painformuar	24,9%	25,1%	25,0%
Aspak të informuar	31,4%	49,1%	40,1%
Gjithsej	100,0%	100,0%	100,0%

Tabela 1.2

MOSHA (2020)	18-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65+	TOTAL
Shumë të informuar	5,4%	3,1%	0,5%	2,4%	4,5%	1,8%	2,9%
Deridiku të informuar	31,9%	29,5%	36,4%	31,9%	32,1%	30,0%	32,1%
Deridiku të painformuar	25,9%	31,5%	25,0%	20,5%	18,8%	20,9%	24,9%
Aspak të informuar	36,8%	35,8%	38,2%	45,2%	44,6%	47,3%	40,1%
Gjithsej	100,0%	100,0%	100,0%	100,0%	100,0%	100,0%	100,0%

Nga cilat burime keni marrë informacione mbi Gjykatën Speciale të Kosovës deri tash?

Tabela 2.1

PËRKATËSIA ETNIKE (2020)	TOTAL % (2020)	SHQIPTARË-K	SERBË-K	TË TJERË-K
Gazetat nacionale	4,5%	9,0%	57,1%	6,2%
Portalet e medave online	17,4%	37,6%	54,4%	27,7%
Mediat sociale (Facebook, Twitter, etj.)	19,1%	41,3%	40,2%	45,6%
TV stacionet	37,3%	80,9%	84,1%	73,6%
Radio stacionet	3,7%	8,1%	0,0%	8,0%

Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC-të) /	1,2%	2,7%	0,0%	2,9%
Organizatat Joqeveritare (OJQ-të)				
Raportet e pavarura të gazetarisë hulumtuese	2,0%	4,3%	5,8%	2,9%
Drejtëpërdrejtë nga Ekipi i Kontaktit i Dhomave të Specializuara të Kosovës	1,4%	2,9%	0,0%	5,3%
Uebfaqja e Gjykatës Speciale dhe/apo deklaratat e zyrtarëve të Gjykatës Speciale	1,4%	3,2%	0,0%	0,0%
Deklaratat e politikanëve shqiptarë	5,8%	12,4%	0,0%	27,9%
Deklaratat e politikanëve serbë	0,6%	0,2%	54,6%	3,4%
Deklaratat e përfaqësuesve ndërkombëtarë (p.sh. BE-ja dhe ambasadat)	1,2%	2,6%	10,2%	0,0%
EULEX	0,2%	0,4%	2,5%	0,0%
Fjalët e dëgjuara	4,1%	8,0%	54,7%	5,3%
Tjetër	0,2%	0,4%	0,0%	0,0%
Pa përgjigje/Refuzoj	0,1%	0,2%	0,0%	0,0%
Gjithsej	100,0%			

Tabela 2.2

MOSHA (2020)	18-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65+
Gazetat nationale	26,6%	7,5%	6,7%	4,9%	4,4%	2,7%
Portalet e mediave online	54,4%	53,4%	39,5%	20,1%	16,3%	5,4%
Mediat sociale (Facebook, Twitter, etj.)	58,0%	58,5%	35,1%	31,1%	22,3%	10,7%
TV stacionet	69,0%	80,7%	80,7%	87,8%	85,5%	89,3%
Radio stacionet	17,1%	6,2%	7,2%	7,1%	2,4%	2,7%
Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC-të) /	6,2%	4,7%	1,0%	0,0%	0,0%	0,0%
Organizatat Joqeveritare (OJQ-të)						
Raportet e pavarura të gazetarisë hulumtuese	2,7%	5,5%	5,6%	1,2%	5,4%	5,4%
Drejtëpërdrejtë nga Ekipi i Kontaktit i Dhomave të Specializuara të Kosovës	2,1%	4,7%	2,1%	3,5%	3,6%	0,0%
Uebfaqja e Gjykatës Speciale dhe/apo deklaratat e zyrtarëve të Gjykatës Speciale	4,4%	3,7%	4,1%	1,2%	0,0%	2,7%
Deklaratat e politikanëve shqiptarë	9,2%	17,2%	15,1%	9,4%	9,7%	8,0%
Deklaratat e politikanëve serbë	0,2%	1,2%	1,6%	1,4%	3,5%	0,0%
Deklaratat e përfaqësuesve ndërkombëtarë (p.sh. BE-ja dhe ambasadat)	0,9%	3,3%	1,3%	4,7%	4,0%	2,7%
EULEX	0,0%	1,7%	0,0%	0,0%	0,0%	0,0%
Fjalët e dëgjuara	4,1%	11,0%	8,2%	9,4%	8,5%	13,4%
Tjetër	0,9%	0,0%	0,0%	1,2%	0,0%	0,0%
Pa përgjigje/Refuzoj	0,0%	0,7%	0,0%	0,0%	0,0%	0,0%

Sa e konsideroni veten të informuar mbi Gjykatën Speciale të Kosovës?

Tabela 1.1

GJINIA (2020)	MASHKULL	FEMËR	GJITHSEJ
Shumë të informuar	3,7%	1,9%	2,9%
Deridiku të informuar	40,0%	23,8%	32,1%
Deridiku të painformuar	24,9%	25,1%	25,0%
Aspak të informuar	31,4%	49,1%	40,1%
Gjithsej	100,0%	100,0%	100,0%

Tabela 1.2

MOSHA (2020)	18-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65+	TOTAL
Shumë të informuar	5,4%	3,1%	0,5%	2,4%	4,5%	1,8%	2,9%
Deridiku të informuar	31,9%	29,5%	36,4%	31,9%	32,1%	30,0%	32,1%
Deridiku të painformuar	25,9%	31,5%	25,0%	20,5%	18,8%	20,9%	24,9%
Aspak të informuar	36,8%	35,8%	38,2%	45,2%	44,6%	47,3%	40,1%
Gjithsej	100,0%	100,0%	100,0%	100,0%	100,0%	100,0%	100,0%

Nga cilat burime keni marrë informacione mbi Gjykatën Speciale të Kosovës deri tash?

Tabela 2.1

PËRKATËSIA ETNIKE (2020)	TOTAL % (2020)	SHQIPTARË-K	SERBË-K	TË TJERË-K
Gazetat nacionale	4,5%	9,0%	57,1%	6,2%
Portalet e medave online	17,4%	37,6%	54,4%	27,7%
Mediat sociale (Facebook, Twitter, etj.)	19,1%	41,3%	40,2%	45,6%
TV stacionet	37,3%	80,9%	84,1%	73,6%
Radio stacionet	3,7%	8,1%	0,0%	8,0%

Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC-të) /	1,2%	2,7%	0,0%	2,9%
Organizatat Joqeveritare (OJQ-të)				
Raportet e pavarura të gazetarisë hulumtuese	2,0%	4,3%	5,8%	2,9%
Drejtëpërdrejtë nga Ekipi i Kontaktit i Dhomave të Specializuara të Kosovës	1,4%	2,9%	0,0%	5,3%
Uebfaqja e Gjykatës Speciale dhe/apo deklaratat e zyrtarëve të Gjykatës Speciale	1,4%	3,2%	0,0%	0,0%
Deklaratat e politikanëve shqiptarë	5,8%	12,4%	0,0%	27,9%
Deklaratat e politikanëve serbë	0,6%	0,2%	54,6%	3,4%
Deklaratat e përfaqësuesve ndërkombëtarë (p.sh. BE-ja dhe ambasadat)	1,2%	2,6%	10,2%	0,0%
EULEX	0,2%	0,4%	2,5%	0,0%
Fjalët e dëgjuara	4,1%	8,0%	54,7%	5,3%
Tjetër	0,2%	0,4%	0,0%	0,0%
Pa përgjigje/Refuzoj	0,1%	0,2%	0,0%	0,0%
Gjithsej	100,0%			

Tabela 2.2

MOSHA (2020)	18-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65+
Gazetat nationale	26,6%	7,5%	6,7%	4,9%	4,4%	2,7%
Portalet e mediave online	54,4%	53,4%	39,5%	20,1%	16,3%	5,4%
Mediat sociale (Facebook, Twitter, etj.)	58,0%	58,5%	35,1%	31,1%	22,3%	10,7%
TV stacionet	69,0%	80,7%	80,7%	87,8%	85,5%	89,3%
Radio stacionet	17,1%	6,2%	7,2%	7,1%	2,4%	2,7%
Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC-të) /	6,2%	4,7%	1,0%	0,0%	0,0%	0,0%
Organizatat Joqeveritare (OJQ-të)						
Raportet e pavarura të gazetarisë hulumtuese	2,7%	5,5%	5,6%	1,2%	5,4%	5,4%
Drejtëpërdrejtë nga Ekipi i Kontaktit i Dhomave të Specializuara të Kosovës	2,1%	4,7%	2,1%	3,5%	3,6%	0,0%
Uebfaqja e Gjykatës Speciale dhe/apo deklaratat e zyrtarëve të Gjykatës Speciale	4,4%	3,7%	4,1%	1,2%	0,0%	2,7%
Deklaratat e politikanëve shqiptarë	9,2%	17,2%	15,1%	9,4%	9,7%	8,0%
Deklaratat e politikanëve serbë	0,2%	1,2%	1,6%	1,4%	3,5%	0,0%
Deklaratat e përfaqësuesve ndërkombëtarë (p.sh. BE-ja dhe ambasadat)	0,9%	3,3%	1,3%	4,7%	4,0%	2,7%
EULEX	0,0%	1,7%	0,0%	0,0%	0,0%	0,0%
Fjalët e dëgjuara	4,1%	11,0%	8,2%	9,4%	8,5%	13,4%
Tjetër	0,9%	0,0%	0,0%	1,2%	0,0%	0,0%
Pa përgjigje/Refuzoj	0,0%	0,7%	0,0%	0,0%	0,0%	0,0%

Sipas mendimit tuaj, cilat lloje të krimeve të kryera gjatë dhe pas luftës 1998-1999 duhet të trajtohen?

Tabela 3

MOSHA (2020)	18-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65+	TOTAL
E rëndësishme të trajtohen krimet që i kanë vuajtur civilët shqiptarë	42,9%	37,3%	34,2%	36,9%	43,4%	46,9%	39,2%
E rëndësishme të trajtohen krimet që i kanë vuajtur civilët serbë	6,9%	5,4%	8,1%	9,5%	9,7%	8,8%	7,7%
E rëndësishme të trajtohen krimet që i kanë vuajtur të gjithë civilët	39,2%	46,5%	45,5%	45,8%	38,1%	31,0%	42,3%
Nuk e di/Pa përgjigje	11,1%	10,8%	12,2%	7,7%	8,8%	13,3%	10,7%
Gjithsej	100,0%	100,0%	100,0%	100,0%	100,0%	100,0%	100,0%

Gjykata Speciale e Kosovës do të ndjekë penalisht vetëm krimet e rënda të kryera në Kosovë në periudhën 1998-2000 të përshkruara në hetimin e vitit 2011 (Këshilli i Evropës “Raporti i Dik Martit”), i cili kryesishët i mbulon krimet e pretenduara të lidhura me Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Si e shihni ju këtë marrëveshje?

Tabela 4

GJINIA (2020)	MASHKULL	FEMËR	GJITHSEJ
E drejtë	15,8%	21,4%	18,5%
E padrejtë	84,2%	78,6%	81,5%
Gjithsej	100,0%	100,0%	100,0%

A është formimi i Gjykatës Speciale (aktakuzat, gjykimet dhe dënimet e mundshme) diçka e mirë apo diçka e keqe për Kosovën?

Tabela 5

MOSHA (2020)	18-24	25-34	35-44	45-54	55-64	65+	TOTAL
Diçka e mirë	19,9%	23,7%	29,0%	29,4%	27,5%	31,7%	26,3%
Diçka e keqe	60,2%	53,5%	49,8%	55,0%	57,8%	51,5%	54,4%
Nuk e di	19,9%	22,8%	21,3%	15,6%	14,7%	16,8%	19,3%
Gjithsej	100,0%	100,0%	100,0%	100,0%	100,0%	100,0%	100,0%

Sa jeni të interesuar në procesin e punës së Gjykatës Speciale?

Tabela 6

GJINIA (2020)	MASHKULL	FEMËR	GJTIHSEJ
Shumë të interesuar	8,4%	3,8%	6,2%
Të interesuar	48,5%	42,0%	45,4%
Të painteresuar	22,4%	27,1%	24,7%
Aspak të interesuar	20,7%	27,1%	23,8%
Gjithsej	100,0%	100,0%	100,0%

Cili është burimi më i besueshëm i informacionit në lidhje me proceset / gjykimet që do të zhvillohen në Gjykatën Speciale?

Tabela 7.1

	2020	2017
Uebfaqja e Gjykatës Speciale	6,3%	9,9%
Deklaratat e zyrtarëve të Gjykatës Speciale	8,4%	13,1%
Procedurat gjyqësore dhe dëshmitë e viktimave	5,0%	12,8%
Mediat	51,5%	25,9%
OJQ-të	5,0%	4,7%
Raportet e pavarura te gazetarisë hulumtuese	5,8%	14,7%
Deklaratat e politikanëve shqiptarë	7,3%	4,6%
Deklaratat e politikanëve serbë	2,3%	1,3%
Deklaratat e përfaqësuesve ndërkombëtarë, duke përfshirë BE-në dhe ambasadat	3,4%	9,8%
EULEX	0,9%	1,1%
Tjetër	0,9%	,0%
Pa përgjigje/Refuzoj	3,1%	2,2%
Gjithsej	100,0%	100,0%

Tabela 7.2

PËRKATËSIA ETNIKE (2020)	SHQIPTARË-K	SERBË-K	TË TJERË-K
Uebfaqja e Gjykatës Speciale	9,4%	16,5%	4,1%
Deklaratat e zyrtarëve të Gjykatës Speciale	13,2%	7,4%	10,4%
Procedurat gjyqësore dhe dëshmitë e viktimave	7,7%	8,3%	5,8%
Mediat	79,6%	51,0%	75,4%
OJQ-të	7,6%	3,4%	10,7%
Raportet e pavarura te gazetarisë hulumtuese	9,4%	4,7%	2,0%
Deklaratat e politikanëve shqiptarë	11,4%	0,0%	13,5%
Deklaratat e politikanëve serbë	2,2%	31,2%	3,2%
Deklaratat e përfaqësuesve ndërkombëtarë, duke përfshirë BE-në dhe ambasadat	4,9%	9,9%	7,6%
EULEX	1,2%	3,9%	1,9%
Tjetër	1,4%	0,0%	1,0%
Pa përgjigje/Refuzoj	3,9%	22,9%	6,3%



Sint Jacobsstraat 12

3511 BS Utrecht

The Netherlands

www.paxforpeace.nl

info@paxforpeace.nl

+31 (0)30 233 33 46

P.O. Box 19318

3501 DH Utrecht

The Netherlands